# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6762
E shtunë, 19 nëntor 2022
çmimi 0.40


## Spitalet, pa penj kirurgjikë
FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


INTERVISTË ME PUBLICISTIN MUAHMET MAVRAJ NË EMISIONIN E MBRËMJES INFONATA TË TËVË1, "VIZITA E MAVRAJT NË HAGË DHE EKSPOZITA E SELIMIT NË PRISHTINË" (16 NËNTOR 2022) FAQE 8-11

# SAKRIFICA E NJERËZVE TANË NË HAGË ËSHTË MË E VOGLA QË ATA ISHIN DHE JANË NË GJENDJE TA BËJNË PËR KOSOVËN

Qeveria po e stimulon spastrimin etnik të Kosovës



Aleatët tanë po i humbim me gjuhën e pistë, - ata po kalojnë në retorikën e serbëve

# SI PO ZËVENDËSOHEN SERBËT E DORËHEQUR NGA INSTITUCIONET E KOSOVËS?
FAQE 4-5

Institucionet e ndryshme në Kosovë kanë nisur punën për mbulimin e detyrave të qytetarëve serbë që kanë dhënë dorëheqje masivisht. Qindra qytetarë serbë të Kosovës, kryesisht nga katër komunat veriore të vendit, kanë hequr dorë nga pozitat e tyre në institucionet e Kosovës që nga 7 nëntori në kundërshtim të vendimit për riregjistrimin e targave të veturave. Dorëheqjet janë dorëzuar në policia, gjykata e prokuroria, dogana e të tjera





## KURTI KONFIRMON SE PO ZHVILLOHEN NEGOCIATA PËR ÇËSHTJEN E TARGAVE
FAQE 3



## TAHIRI: QEVERIA PO GRABIT TË HYRAT VETJAKE TË KOMUNAVE
FAQE 7

## AKTUALE



SULMET E RUSISË LËNË 10 MILIONË UKRAINAS PA ENERGJI ELEKTRIKE F. 2

SHTOHEN KATEGORI TË REJA NË RAUNDIN E DYTË TË SUBVENCIONEVE PËR PAJISJET EFIÇIENTE F. 3

POLICIA E KOSOVËS DHE AJO E SHQIPËRISË NËNSHKRUAJNË MEMORANDUM BASHKËPUNIMI F. 3

## EKONOMI



MINISTRJA HAJDARI: PËRKRAHJA E NDËRMARRËSISË, FAKTOR KYÇ PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK F. 12

KEDS-I I INFORMON NXËNËSIT SESI DUHET TË KURSEHET ENERGJIA ELEKTRIKE F. 12

## SPORT



KOMITETI PARAOLIMPIK PËR HERË TË PARË NË ASAMBLENË E BERLINIT F. 12


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Sulmet e Rusisë lënë 10 milionë ukrainas pa energji elektrike

Kiev, 18 nëntor - Më shumë se 10 milionë ukrainas mbetën pa energji elektrike pas një valë të re sulmesh ruse ndaj infrastrukturës kritike, ndërsa janë rritur shqetësimet për furnizimin me energji elektrike të Ukrainës me afrimin e sezonit dimëror dhe uljen e temperaturave në mbarë vendin.
Sipas kompanisë shtetërore të energjisë "Ukrenergo", rrjeti energjetik në vend është duke punuar në limite pasi ulja e temperaturave dhe dëmtimet e shumta si pasojë e sulmeve të reja nga raketat ruse e kanë bërë të pamundur furnizimin me kohë të plotë të qytetarëve. "Për shkak të rënies dramatike të temperaturave, konsumi i energjisë elektrike po rritet çdo ditë në ato rajone të Ukrainës ku furnizimi me energji tashmë është rikthyer pas sulmeve me raketa më 15 nëntor në infrastrukturën energjetike", bëri të ditur "Ukrenergo" në një deklaratë të lëshuar të premten. "Kjo e ndërlikon akoma më shumë situatën e vështirë në sistemin energjetik".
Ukrenergo tha se po kufizonte përdorimin e energjisë elektrike në disa zona si "një masë e nevojshme për të ruajtur stabilitetin e sistemit energjetik" dhe kishte dërguar ekipe "duke punuar gjatë gjithë kohës për të rivendosur infrastrukturën e dëmtuar në mënyrë që të kthente delektricitetin tek ukrainasit".
Sulmet e kësaj jave me raketa goditën infrastrukturën kritike në qytetet anembanë Ukrainës, pasi në shumë pjesë të vendit, përfshi në kryeqytetin Kiev, u panë reshjet e para të borës.
Presidenti Volodymyr Zelensky tha se më shumë se 10 milionë ukrainas nuk kanë energji elektrike. "Shumica e tyre janë në rajonet Vinnytsia, Odesa, Sumy dhe Kiev", tha ai në fjalimin e tij të enjten.
Zelensky tha se ekipet e inxhinierëve po bënin gjithçka për të normalizuar furnizimin, por kishte "përsëri ndërprerje urgjente, përveç atyre të planifikuara të stabilizimit".
"Yasno", një furnizues i energjisë elektrike në Kiev, tha se qyteti kishte përjetuar ndërprerje emergjente gjatë gjithë ditës të enjten, me rrjetin që kishte më pak se gjysmën e furnizimit të tij normal.
Bombardimet dhe sulmet me raketa ruse goditën infrastrukturën civile në pjesë të ndryshme të Ukrainës gjatë natës së të enjtes.



Zelensky tha se dhjetëra njerëz u plagosën si rezultat i një sulmi raketor në Dnipro, ndërsa në Zaporizhia shtatë trupa u gjetën nën rrënojat e një ndërtese banimi të shkatërruar nga bombardimet ruse. Dy trupa të tjerë u gjetën më vonë në Zaporizhia, duke e çuar numrin e viktimave në nëntë.
Tre persona të tjerë u shtruan në spital pasi u plagosën në sulmet me raketa në Izium në rajonin e Harkivit. Disa objekte të prodhimit të gazit në Ukrainën lindore u shkatërruan dhe të tjera u dëmtuan nga bombardimet, ndërsa edhe rajoni jugor i Odesës u godit gjithashtu nga sulmet me raketa ruse.
Zelensky ka akuzuar Rusinë për "terrorizëm energjetik" mbi sulmet e saj të përsëritura në infrastrukturën kryesore. "Vetë fakti që Rusia i është drejtuar terrorit kundër sektorit të energjisë tregon dobësinë e armikut. Ata nuk mund ta mposhtin Ukrainën në fushën e betejës dhe për këtë arsye ata po përpiqen të thyejnë popullin tonë në këtë mënyrë", tha Zelensky.

# Navalny dërgohet në izolim të përhershëm



Moskë, 18 nëntor - Lideri i burgosur i opozitës ruse, Aleksei Navalny, ka bërë me dije se është transferuar përgjithmonë në një qeli izolimi që do të kufizonte kontaktin e tij me të burgosurit e tjerë dhe botën e jashtme.
Navalny u vendos në izolim, i quajtur gjithashtu "qeli dënimi", më 1 nëntor, por mund të mbahej atje vetëm për 15 ditë, sipas postimit në Instagram.
Ai tha se izolimi i tij i ri është "një qeli e rregullt e ngushtë, si qelia e dënimit, përveç që mund të kesh jo një, por dy libra, dhe të përdorësh kioskën e burgut, megjithëse me një buxhet shumë të kufizuar". "Ata po e bëjnë këtë për të më mbajtur të heshtur", tha Navalny në postimet e tij në rrjetet sociale , duke shtuar se qëndrimi në qelinë e vogël dhe të ngushtë zakonisht kufizohej në 15 ditë si dënim. Rregullat gjithashtu ndalojnë "vizitat e gjata" nga të afërmit, tha ai.
Urdhri u dha vetëm katër ditë para se familja e tij të vinte ta takonte. Navalny u burgos në Koloninë Famëkeqe Nr. 2, në lindje të Moskës, në mars 2021 pasi u kthye në Rusi nga Gjermania, ku po rikuperohej pas një helmimi. Zyrtarët e Shtëpisë së Bardhë thanë se agjencitë amerikane të inteligjencës kishin arritur në përfundimin se agjentët e policisë ruse të sigurisë e kishin helmuar Navalnyn.
Edhe pse e dinte për rrezikun që mund të arrestohej dhe të dënohej me burgim për shkeljen e lirimit me kusht duke shkuar në Gjermani, Navalny u kthye në vendlindje. Ai ishte bërë lideri më i shquar i opozitës ruse duke publikuar korrupsionin e nivelit të lartë dhe duke sfiduar presidentin Vladimir Putin në qendrat e votimit.

# FBI e shqetësuar rreth raportimeve për stacione policore kineze në ShBA

Nju-Jork, 18 nëntor - Byroja Federale e Hetimeve (FBI) është shprehur e shqetësuar nga raportimet se në tokën amerikane janë krijuar stacione sekrete policore të lidhura me Kinën.
Në një raport të hartuar në muajin shtator nga organizata joqeveritare, Mbrojtësit e Sigurisë, është përmendur prezenca e këtyre stacioneve në shumë vende të botës, përfshirë Nju Jorkun.
Drejtori i FBI-së, Christopher Wray, u ka thënë politikanëve se agjencia është duke monitoruar raportimet për qendra të tilla. "Ne jemi të vetëdijshëm për ekzistencën e këtyre stacioneve. Për mua është mizore vetëm të mendoj se policia kineze do të tentonte të stacionohej në Nju Jork pa koordinim paraprak. Një gjë e tillë shkel sovranitetin dhe standardet gjyqësore, por edhe procesin e bashkëpunimit mes zyrtarëve për zbatim të ligjit", ka thënë Wray.




EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Kurti konfirmon se po zhvillohen negociata për çështjen e targave

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të premten se zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, është në komunikim të vazhdueshëm me Brukselin për ta zgjidhur çështjen e targave. Sipas tij, në ditët në vijim do të shihet nëse do të kenë sukses negociatat e reja.
Ai i ka bërë këto deklarata në Estoni, në një konferencë të përbashkët për medie me kryeministren estoneze Kaja Kallas. "Janë 9 mijë vetura me targa ilegale serbe. Kjo është më pak se 10 për qind e veturave që i kanë serbët në Kosovë, kështu që është një pakicë ekstreme e serbëve që janë duke refuzuar këto targa. Kemi pasur një dallim në qasje dhe sekuencim të zbatimit, duke nisur vetëm me qortim".
Tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë janë rritur prej se Qeveria e Kosovës ka nisur më 1 nëntor zbatimin e planit të saj për riregjistrimin e makinave me targa të paligjshme serbe. Këto makina qarkullojnë kryesisht në veri të Kosovës, ku popullata shumicë është serbe dhe kontrollohet në masë të madhe nga Beogradi zyrtar. Qeveria e Kosovës do që të gjitha makinat të riregjistrohen me targa RKS, apo Republika e Kosovës, por Serbia kundërshton, duke insistuar në targa neutrale ndaj statusit të Kosovës. Si pasojë e tensioneve të rritura, serbët e veriut i kanë braktisur institucionet e Kosovës.



# Shtohen kategori të reja në raundin e dytë të subvencioneve për pajisjet efiçiente

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ




PRISHTINË, 18 NËNTOR - Ministrja e Ekonomisë në Kosovë, Artane Rizvanolli, ka paraqitur të premten raundin e dytë për ndarjen e subvencioneve për qytetarët që blejnë pajisje efiçiente për ngrohje. Ajo ka thënë se në raundin e dytë janë shtuar edhe disa kategori të tjera, pas ankesave dhe sugjerimeve që kanë marrë komisionet nga qytetarët. Sipas saj, në raundin e parë janë subvencionuar 2 228 qytetarë në vlerë të 1.4 milion eurove.
Raundi i parë ka nisur më 6 tetor dhe ka përfunduar më 7 nëntor.
Edhe raundi i dytë, sikurse i pari, ka dy faza. E para nis më 18 nëntor dhe përfundon më 25 nëntor, ndërsa e dyta përfundon më 9 dhjetor.
Aplikimi bëhet online në platformën eKosova.
Sipas statistikave, më së shumti energji elektrike në Kosovë shpenzon sektori i amvisërisë, me rreth 40 për qind të konsumit të përgjithshëm.

## Kush mund të aplikojë në raundin e dytë?

Sikur edhe në raundin e parë, edhe në të dytin do të subvencionohen qytetarët që pajisen me pompë termike, pompë termike ajër-ajër të tipit inverter me efiçiencë të lartë (kondicioner/ klimë eficiente), kaldaja me biomasë (dru, pelet, briket) dhe stufa individuale me biomasë.
Në raundin e dytë u është mundësuar subvencionimi edhe përfituesve të skemës sociale në deri 60 për qind të vlerës, ose jo më shumë se 550 euro.
Rizvanolli ka thënë se Ministria e Ekonomisë është duke bashkëpunuar me qendrat sociale nëpër komuna, që t'u ofrohet ndihmë përfituesve të skemave sociale për të aplikuar për ndihmën.
Në raundin e dytë janë përfshirë edhe nënat vetushqyese.
Për blerje të këtyre pajisjeve ato do të mund të fitojnë deri në 90 për qind të shumës, por jo më shumë se 560 euro.
Verifikimi i statusit do të bëhet në platformën eKosova.
Ministrja Rizvanolli ka thënë se në fazën e parë kanë pranuar ankesa nga bizneset se nuk kanë mundur të aplikojnë në pamundësi të montimit të këtyre pajisjeve si pasojë e mungesës së fuqisë punëtore. Prandaj, ajo ka thënë se në raundin e dytë, bizneset do të mund t'i blejnë pajisjet, t'i fotografojnë ato dhe të aplikojnë, por pajisjet duhet të montohen deri më 10 janar 2023, kur edhe do të nisë inspektimi.
Në raundin e dytë mund të aplikojnë edhe të gjithë individët që kanë aplikuar në fazën e parë, e që nuk kanë arritur t'i montojnë pajisjet e tyre në kohë.
Rizvanolli ka thënë se në raundin e dytë i kanë përfshirë edhe konsumatorët që në orët e tyre nuk kanë harxhuar më shumë se 800 kilovat energji elektrike - pra kryesisht pronarët e shtëpive dhe banesave të reja.
Për këtë kategori mjafton që konsumatorët të kenë orën të regjistruar nga 1 nëntori 2021 deri më 31 tetor 2022 dhe do të mund të përfitojnë subvencione.
Ministrja u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve që kur të kualifikohen për fazën e dytë, ta finalizojnë aplikimin sa më shpejt që është e mundur për shkak të përfundimit të vitit buxhetor.

# Policia e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Ushtruesi i detyrës i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Fehmi Hoti, ka pritur në takim drejtorin e Policisë së Shtetit të Republikës së Shqipërisë, Muhamet Rrumbullaku.
Në takim, pos dy krerëve të institucioneve, mori pjesë edhe manaxhmenti i lartë i Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shqipërisë.
U diskutuan tema që lidhen me natyrën e punës policore, me theks të veçantë në bashkëpunimin mes dy policive, si dhe u nënshkrua një memorandum në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor.
Zotimi i dy përfaqësuesve kryesorë të dy institucioneve policore ishte se bashkëpunimi mes dy policive do të ngrehet në vazhdimësi dhe në të ardhmen do të vazhdojë edhe në fusha të reja me interes të përbashkët.






# Si po zëvendësohen serbët e dorëhequr nga institucionet e Kosovës?

Prishtinë, 18 nëntor - Institucionet e ndryshme në Kosovë kanë nisur punën pr mbulimin e detyrave të qytetarëve serbë që kanë dhënë u dorëheqje masivisht.

Qindra qytetarë serbë të Kosovës, kryesisht nga katër komunat veriore të vendit, kanë hequr dorë nga pozitat e tyre në institucionet e Kosovës që nga 7 nëntori në kundërshtim të vendimit për riregjistrimin e targave të veturave.

Dorëheqjet janë dorëzuar në policia, gjykata e prokuroria, dogana e të tjera.

Edhe përfaqësuesit politikë në nivel lokal kanë dhënë dorëheqje duke çuar në nevojën për zgjedhje të parakohshme në katër komuna të banuara me shumicë serbe, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.

Po ashtu, edhe 10 deputetë në Kuvendin e Kosovës kanë dhënë dorëheqje.

Zëvendësimi i tyre është bërë të mërkurën, më 17 nëntor.

"Radio Evropa e Lirë" ka mbledhur të dhëna nga institucionet të cilat janë përballur me dorëheqje të stafit në lidhje me shifrat e dorëheqjeve dhe planet për zëvendësimin e këtyre punëtorëve.

Deri më tani, sipas të dhënave nga institucionet, nuk janë hapur konkurse për plotësimin e vendeve nga jashtë, por në shumicë janë bërë rialokime të stafit ekzistues për pozitat që kanë mbetur të zbrazura.

## Policia: Zëvendësim gradual

Ministri i Punëve të Brendshme i Qeverisë së Kosovës, Xhelal Sveçla, në një konferencë për media, më 7 nëntor, deklaroi se dorëheqjen e kanë dorëzuar 578 zyrtarë policorë nga radhët e komunitetit serb në veri të Kosovës.

Në një përgjigje për "REL", Policia e Kosovës ka thënë se pas dorëheqjeve "do të rriten gradualisht kapacitetet policore me zyrtarë të rendit publik, në numër të mjaftueshëm duke u bazuar në nevojat dhe vlerësimet operacionale". Ata nuk kanë sqaruar më tej se a do të hapin konkurs të ri në një të ardhme të afërt për zëvendësimin e policëve në atë zonë. "Policia ka kapacitete të mjaftueshme policore dhe veprimet do t'i ndërmarrë konform autorizimeve ligjore dhe kushtetuese me qëllim të ofrimit të sigurisë dhe shërbimit ndaj qytetarëve në të gjitha rastet që paraqiten", thuhet në përgjigjen e policisë.

## Prokuroria: Transferime prokurorësh

Dhjetë prokurorë e 22 punëtorë të administratës më 7 nëntor dhanë dorëheqje nga prokuroria. Kjo prokurori përfshin territorin e Mitrovicës së Jugut, të Veriut, të Leposaviqit, të Zubin Potokut, të Zveçanit, të Skenderajt dhe të Vushtrrisë.

Ismet Ujkani, kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, tha për "REL" se dorëheqjet nga ky institucion "e kanë bërë më të vështirë punën".

Ai ka treguar se Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), që është përgjegjës për rekrutimet e prokurorëve, e ka ndihmuar këtë prokurori me transferime nga jashtë. "Aktualisht janë transferuar tre prokurorë prej prokurorive të tjera. Prej Prokurorisë së Ferizajt një dhe prej Prokurorisë së Prishtinës", ka thënë Ujkani.

Këshilli Prokurorial i Kosovës nuk i është përgjigjur pyetjes së "REL"-it se a do të ketë konkurs për zëvendësimin e prokurorëve, duke thënë se "për çdo veprim që do të merret në lidhje me situatën e krijuar, opinioni publik do të njoftohet me kohë".

Çfarë thotë ligji për dorëheqjen e prokurorëve dhe gjyqtarëve?

Me dorëheqjen eventuale të gjykatësve dhe prokurorëve, atyre edhe ligjërisht u përfundon mandati. Për të krijuar efekte juridike, dorëheqja e një prokurori apo gjyqtari fillimisht duhet të miratohet nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe përkatësisht Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Pas kësaj, Këshilli e dërgon vendimin për lirimin nga puna e gjyqtarit te Presidenca e Kosovës.

Presidenca brenda 30 ditësh duhet ta nxjerrë dekretin për lirimin nga detyra e prokurorit. E njëjta procedurë vlen edhe për dorëheqjet e gjyqtarëve.

## Gjyqësori: Riorganizim stafi brenda gjykatës

Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk i është përgjigjur pyetjes se sa është numri total i të dorëhequrve nga Gjykata Themelore në Mitrovicë. Megjithatë, Bekim Veliqi, nënkryetar i Gjykatës në Mitrovicë, tha për REL-in se numri i të dorëhequrve nga gjykata dhe degët e saj arrin në 130. "I gjithë stafi (serb) që ka qenë, të gjithë kanë dhënë dorëheqje", tha Veliqi.

Ndër të dorëhequrit është edhe kryetarja e kësaj gjykate, Lilana Stevanoviq.

Nënkryetari Veliqi tha për "REL"-in se aktualisht kanë bërë vetëm riorganizim të brendshëm për ta mundësuar funksionimin e gjykatës. "Ne jemi riorganizuar vetë si gjykatë, sipas obligimit që na ka rrjedhur nga mbledhja e jashtëzakonshme e Këshillit Gjyqësor të Kosovës më 7 nëntor. Kemi bërë lëvizje të gjyqtarëve brenda gjykatës", sqaroi Veliqi.

Ai theksoi se KGJK-ja e ka caktuar një koordinator që në komunikim me Gjykatën e Mitrovicës do të përcaktojë nëse duhet t'i transferojnë lëndët nëpër gjykata të tjera të Kosovës. "Ne si gjykatë jemi të ngarkuar me lëndë të krimeve të rënda. I kemi diku 1 400 raste në krime të rënda", tregoi Veliqi.

Serbët ishin integruar në sistemin e drejtësisë dhe atë të rendit, pasi Kosova dhe Serbia

→

më 2013, në kuadër të dialogut për normalizimin e raporteve, kishin arritur marrëveshje për një gjë të tillë.

## Dogana rialokoi stafin

Me dorëheqje u përball edhe Dogana e Kosovës, nga zyrtarë që punonin në zonat kufitare Kosovë - Serbi në Jarinjë dhe Bërnjak, në veri të Kosovës.

Nga Dogana i kanë thënë "REL"-it se 11 zyrtarë janë dorëhequr. "Nëntë nga këta zyrtarë janë të nacionalitetit serb dhe dy boshnjakë", thuhet në përgjigjen e Doganës. Sipas përgjigjes së tyre, Dogana ka alokuar staf shtesë në pikëkalimet kufitare për t'i zëvendësuar personat e larguar. As Dogana nuk i është përgjigjur pyetjes nëse pritet të hapet konkurs për zëvendësimin e zyrtarëve të dorëhequr.

## KQZ: Ende nuk dihet si do të zëvendësohen të dorëhequrit

Në kuadër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për secilën komunë caktohet nga një udhëheqës i asaj që quhet Komision Komunal i Zgjedhjeve (KKZ). Sipas Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme, KKZ-ja është organ përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve zgjedhore brenda territorit të komunës.

KKZ-të përbëhen nga kryesuesi që është i punësuar nga KQZ-ja, si dhe anëtarët që nominohen nga subjektet politike që kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet nacionale, nëse i nënshtrohen pragut zgjedhor.

Në vazhdën e dorëheqjeve, në katër komunat e veriut, dorëheqje dhanë edhe katër kryesuesit e KKZ-ve në ato katër komuna. "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është duke e trajtuar këtë çështje dhe së shpejti do të kemi një njoftim se si do të procedojmë në këtë drejtim", kanë thënë nga KQZ-ja për REL-in. KQZ-ja tha se, gjithashtu, është në fazën e ndërtimit të trupave zgjedhore, konkretisht Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve për komunat: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.

"Për këtë qëllim, KQZ-ja u ka dërguar ftesë subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës që t'i dorëzojnë propozimet e tyre për nominimin e anëtarëve në këto komisione komunale deri më 20 nëntor në orën 16:00", thuhet në përgjigjen e KQZ-së.

## Kuvendi i Kosovës

Procedura e zëvendësimit ka përfunduar për dhjetë deputetë të Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve të Kosovës - të cilët dhanë dorëheqje në javën e parë të nëntorit. Të mërkurën dhjetë deputetë të rinj janë betuar në Kuvendin e Kosovës duke marrë mandatet për t'i zëvendësuar deputetët e dorëhequr.

Në Kuvendin e Kosovës u betuan nëntë deputetë të Listës Serbe që janë: Millan Kostiq, Zoran Maksimoviq, Svetislav Gjokiq, Ksenija Bozhoviq, Radosh Mihajlloviq, Bilana Makshiq, Milan Joksimoviq, Nenad Radenkoviq, Olivera Zdravkoviq nga Lista Serbe.

Ndërkaq mandat mori edhe Cvetko Velkoviq nga partia Iniciativa qytetare për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë.

Lista Serbe tha të mërkurën se nëntë deputetët e rinj të kësaj partie u betuan në Kuvendin e Kosovës për t'i "verifikuar teknikisht mandatet e tyre" dhe "për t'i mbajtur ato në duar të sigurta". "Theksojmë se ky vendim strategjik dhe politik në asnjë mënyrë nuk do ta ndalë procesin e largimit nga institucionet e Kosovës në veri të Kosovës dhe Metohisë, me të cilat janë shuar të gjitha institucionet e Kosovës", thuhet në komunikatën e Listës Serbe.

## Komunat e Kosovës në zgjedhje

Presidentja e Kosovës ka shpallur zgjedhjet lokale për katër komunat veriore të vendit që do të mbahen më 18 dhjetor. Në valën e dorëheqjeve të serbëve ishin edhe Zoran Todiq, kryetar i Leposaviqit, Srdjan Vuloviq, kryetar i Zubin Potokut, Dragisha Milloviq, kryetar i Zveçanit, si dhe Millan Radojeviq, kryetar i Mitrovicës së Veriut.

Dorëheqje dhanë edhe anëtarët e kuvendeve komunale nga Lista Serbe që janë shumicë në secilën prej katër komunave veriore.

Ligji për Zgjedhje parasheh që secili anëtar i Kuvendit Komunal që jep dorëheqje duhet të zëvendësohet, por institucionet nuk kanë sqaruar se si do të bëhet zëvendësimi i këtyre mandateve tani për tani.

Në anën tjetër, Qeveria e Kosovës nuk ka kthyer përgjigje se sa shërbyes civilë brenda këtyre administratave komunale janë dorëhequr dhe si pritet të vazhdojë funksionimi i tyre tutje.

## ATK-ja dhe AVUK-i pa dorëheqje

Jo të gjitha institucionet kosovare që kanë të punësuar të komunitetit serb nga komunat veriore u përballën me dorëheqje.

Administrata Tatimore e Kosovës ka thënë për "REL"-in se ka gjithsej 16 të punësuar nga komuniteti serb në zonën e Mitrovicës së Veriut. "Prej tyre, tetë janë inspektorë në Drejtorinë Rajonale të ATK-së në Mitrovicë, si dhe tetë të tjerë në Departamentin e Mbledhjes së Detyrueshme në Prishtinë", ka thënë ATK-ja.

Megjithatë, ky institucion deri më tani nuk ka pranuar asnjë dorëheqje. "Në rast se do të kemi dorëheqje, do të tentojmë të mobilizohemi, duke i zëvendësuar me inspektorë nga regjionet e tjera, në mënyrë që mos të kemi ndalim të aktiviteteve", thuhet në përgjigjen e ATK-së.

Edhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka thënë se ka të punësuar 17 zyrtarë të komunitetit serb dhe prej tyre "14 janë nga komunat veriore". "Deri më tash nuk kemi pranuar asnjë njoftim apo paralajmërim për dorëheqje nga ana e tyre", ka thënë AUV për "Radion Evropa e Lirë".

## "Problemi që kërkon zgjidhje politike"

Albert Krasniqi nga Organizata Demokraci Plus (D+) mendon se zëvendësimi i të larguarve nga institucionet e Kosovës dhe sidomos në nivel politik duhet të bëhet me kujdes. "Është vështirë tani që institucionet e Kosovës të gjejnë zgjidhje përmes një rruge juridike sepse i gjithë ky problem kërkon një zgjidhje politike në mënyrë që përfaqësimi i komunitetit serb në institucionet e Kosovës të jetë përmbajtjesor", thotë ai.

Krasniqi thotë se në strukturat e sigurisë si dorëheqjet në polici "'do të jetë një proces më i gjatë i zëvendësimit".

Ndërkohë, sipas Krasniqit, ftesa për serbët që t'i marrin ulëset në përfaqësim politik sikurse në Kuvendin e Kosovës duhet bërë duke pasur parasysh edhe sigurinë e tyre. "Në institucionet e tjera, si në Kuvendin e Kosovës, është me rëndësi që edhe ata që i marrin këto ulëse, të mos përballen me presion", thotë ai.

Ndërkohë, Lista Serbe - e vlerësuar si partia kryesore e serbëve në Kosovë - tha se nuk do të marrë pjesë në zgjedhjet e shpallura për katër komunat e banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës.

Dushan Radakoviq, nga organizata joqeveritare Qendra për Përfaqësimin e Kulturës Demokratike, për "REL"-in ka thënë më 15 nëntor se zgjedhjet parakohshme në veri mund të organizohen, porse ato nuk do të kenë legjitimitet pa pjesëmarrjen e komunitetit serb.

Dorëheqjet e serbëve erdhën në shenjë kundërshtimi ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për të nisur procesin për riregjistrimin e makinave me targa të paligjshme serbe. Qeveria e Kosovës nga 1 nëntori ka nisur zbatimin e planit të saj për riregjistrimin e makinave me targa ilegale serbe, në targa RKS, Republika e Kosovës.

Faza e dytë do të zbatohet nga 21 nëntori dhe parasheh gjoba deri në 150 euro për të gjithë shoferët e automjeteve me targa ilegale serbe.



© Bojan Slavkovic/AP Photo/picture alliance




# Banorët e Shtëpisë së të Moshuarve "Jetimat e Ballkanit" vizitojnë Prekazin

SKENDERAJ, 18 NËNTOR - Emocione të veçanta nga vizita e banorëve të Shtëpisë së të Moshuarve "Jetimat e Ballkanit", të cilët, bashkë me hoxhën e nderuar, Halil Kastrati, bënë homazhe e nderime te varri i komandantit legjendar Adem Jashari dhe të rënëve të tjerë të familjes Jashari. "Ishte ndjenjë e jashtëzakonshme t'i shohësh të moshuarit duke shprehur gëzimin e tyre për vizitën dhe vlerësimet e tyre për luftën tonë çlirimtare. Bashkë me mixhën Rifat kaluam çaste të bukura duke shkëmbyer tregime të shumta për historinë e familjes dhe sfidat e përbashkëta që kemi kaluar si popull deri në çlirimin e plotë nga okupatori serb", ka shkruar në "Facebook" ish-kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari.

# Ambasada Amerikane i jep mirënjohje nënkryetares së Gjilanit

GJILAN, 18 NËNTOR - Nënkryetarja e komunës së Gjilanit, Leonora Morina-Bunjaku, është nderuar me mirënjohje nga ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey M. Hovenier, pas pjesëmarrjes në Samitin për Demokraci (Programi ndërkombëtar për lidership) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Me këtë rast, nënkryetarja Morina Bunjaku e ka falënderuar ambasadorin Hovenier, Ambasadën Amerikane, USAID-in për nominimin, aranzhimin e Programit të IVLP- Summmit for Democracy dhe pritjen pas kthimit nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Të nominuarit për pjesëmarrje në IVLP Summit for Democracy, si nënkryetare e komunës së Gjilanit në mesin e tetë pjesëmarrësve nga shtete të ndryshme, ishte një përvojë e jashtëzakonshme. Duke na dhënë mundësinë për ta ndarë përvojën tonë me profesionistë të shquar të fushave të ndryshme si pjesëmarrës dhe homologët amerikanë, aktivitete që kemi ndjekur, gjëra të reja që kemi parë dhe mësuar në tre vendet më të bukura dhe më të zhvilluara si Washington DC, Kalamazoo dhe Los Angeles në ShBA!", ka thënë nënkryetarja Morina-Bunjaku.

Ajo ka theksuar se gjatë kësaj periudhe kohore patën mundësi për të fituar njohuri, ide, mjete dhe praktika të reja për ta ndihmuar avancimin e praktikave demokratike, luftimin e korrupsionit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Lehtësimi i zhvillimit të Planeve të Veprimit, angazhimeve për reforma, angazhimi i qytetarëve në aktivitetet vullnetare. "Prandaj edhe si rezultat i përvojave të shumta ne si komunë kemi përzgjedhur si temë të planit të veprimit mes shumë sfidave dhe mundësive, temën 'Qytetarët aktivë në proceset vendimmarrëse'. Ne e vlerësojmë shumë dhe shpresojmë që bashkëpunimi ynë të mos jetë një destinacion, por një udhëtim i gjatë dhe i frytshëm në vazhdimësi", ka thënë nënkryetarja e komunës së Gjilanit, Leonora Morina-Bunjaku.



# 22 shtëpi po ndërtohen në Podujevë për familjet me gjendje të rëndë sociale



PODUJEVË, 18 NËNTOR - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka vizituar shtëpitë të cilat po ndërtohen në afërsi të qytetit të Podujevës nga Fondacioni "Shqiptarët për shqiptarët" për familjet me gjendje të vështirë ekonomike dhe probleme banimi. "Këto shtëpi po ndërtohen nga memorandumi i bashkëpunimit që kemi nënshkruar si komunë me fondacionin e hoxhës, Elvis Naçi, në këto hapësira po ndërtohen 22 shtëpi për familjet me gjendje të rëndë sociale. Jam i kënaqur me cilësinë e punimeve që po zhvillohen dhe funksionalitetin e këtyre objekteve që do të ofrojnë për 22 familje llapjane. Krahas kësaj, si komunë do ta ndërtojmë të gjithë infrastrukturën nëntokësore e mbitokësore", ka thënë Bulliqi, duke falënderuar Fondacionin "Shqiptarët për shqiptarët", familjen Stublla për ofrimin e tokës dhe të gjithë donatorët që po e mundësojnë realizimin e këtij projekti.

## Ngrihet aktakuzë kundër një serbi për krime lufte në Kosovë

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë kundër serbit me inicialet Ç. J, me vendbanim në Serbi, nën dyshimet se ka kryer veprën penale "krim i luftës kundër popullsisë civile".

Aktualisht i dyshuari është në paraburgim deri në vendimin e ri të gjykatës.

Sipas Prokurorisë, i pandehuri akuzohet se gjatë kohës së luftës në Kosovë, në periudhën 1998-1999, ka kryer torturë në komunën e Istogut ndaj personave civilë: Z. M., N. F. dhe N. C. Sipas saj, në procesin e hetimeve janë siguruar prova të mjaftueshme se i dyshuari, bashkë me disa persona të tjerë, ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Në luftën e zhvilluar në Kosovë më 1998/99 janë vrarë mbi 13 000 civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur. Mbi 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë. Kosova ka shpallur pavarësinë në vitin 2008 dhe njihet nga mbi 100 vende të botës.

Serbia nuk e njeh pavarësinë e saj dhe në Kushtetutë vazhdon ta konsiderojë atë si pjesë të territorit të saj.



## Tahiri: Qeveria po grabit të hyrat vetjake të komunave



PRISHTINË, 18 NËNTOR - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka thënë se qeveria po grabit të hyrat vetjake të komunave. Tahiri ka theksuar se Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, me nenin 9, pika 6, ka cenuar autonominë financiare të komunave, ku theksohet se të gjitha të hyrat vetjake të mbledhura para vitit 2022 dhe të pashpenzuara, bëhen pjesë e Fondit të Kosovës në bilancin bankar.
Kushtetuta e Kosovës, neni 124, organizimi dhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale, në pikën 5 përcakton: "Komunat kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga qeveria qendrore në pajtim me ligjin". "Ky provizion është bartur edhe në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, më saktësisht te neni 2 Pavarësia Financiare e Komunave, pika 2.1 për të mirë të popullsisë së komunës, Kuvendi Komunal dhe zyrtarët ekzekutivë kanë të drejtën dhe autorizimin që në mënyrë të pavarur t'i rregullojnë dhe menaxhojnë burimet financiare të cilat rrjedhin nga të hyrat vetjake komunale ose të cilat i janë ndarë komunës në formë të grantit të përgjithshëm. Në vend se të sigurohet financimi, saktësisht investimet e ministrive të linjës, me parime dhe kritere të qarta, nga vizioni politik i prezantuar me grantin e katërt për komunat, apo sipas Draftligjit për Financat e Pushtetit Lokal, ku vendosen parime dhe kritere në grantin për investimet kapitale në komuna, ligj ky që për motive politike është tërhequr nga agjenda legjislative", është shprehur Tahiri.
Ai ka shtuar se ky veprim i qeverisë dëmton dhe pamundëson jo vetëm financimin e qëndrueshëm, por në veçanti financimin e shërbimeve sociale në komuna.

# Spitalet, pa penj kirurgjikë




PRISHTINË, 18 NËNTOR - Në shumicën e klinikave të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), aty ku kryhen operacione kirurgjike, mungojnë penjtë. Rrjedhimisht, pacientët janë të detyruar që vetë t'i blejnë ata për operacione.
Këtë e ka bërë edhe Hajzer Hasani nga Podujeva, bashkëshortja e të cilit më 15 nëntor e ka pasur të caktuar një operacion në Klinikën e Kirurgjisë Abdominale në Prishtinë. "Mjekët me kanë thënë që duhet t'i blejmë vetë penjtë. I kam blerë dhe mund t'i shikoni. Më kanë kushtuar 130 euro. Nuk është në rregull që gjërat elementare të blihen, por në këto raste nuk ke çare pa i blerë. Nuk kemi çka të bëjmë në këtë rast", shtoi ai.
Doktorët kirurgë në QKUK dhe mbikëqyrësit e furnizimeve me materiale për sallat e operacioneve kanë konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" se ka mungesë të penjve si dhe të disa materialeve të tjera [izoluese].
Nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK) shpjegojnë se kjo situatë ka ndodhur për shkak të një ankese të operatorit ekonomik tek Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), pasi që është shpallur fituesi i tenderit nga sektori i prokurimit në ShSKUK. "Për momentin është duke u trajtuar ankesa në OShP", thuhet në një përgjigje me shkrim nga drejtoria e ShSKUK-së.
Ndërsa Drejtoria e ShSKUK-së nuk ka treguar se pse nuk janë bërë planifikimet me kohë duke pasur parasysh edhe mundësinë e ankesave nga operatorët.
Problemi me furnizim të qëndrueshëm me penj ka filluar disa muaj më parë, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" një nga kryeinfermieret në Klinikën e Kirurgjisë. "Që nga vera nganjëherë kemi pasur [penj], e nganjëherë [ka pasur] edhe mungesa, pavarësisht se nga sallat e operacioneve janë bërë porositë në barnatoren qendrore", tha një nga kryeinfermieret e cila nuk deshi të identifikohet.
Kurse me këtë problem nuk ballafaqohen vetëm klinikat në Prishtinë, por edhe spitalet rajonale, siç janë ato në Mitrovicë, Prizren e Pejë. "Penj kirurgjikë nuk kemi që një vit. Për një kohë kemi huazuar nga ShSKUK-ja, deri para tre apo katër muajve, tash duhet të blihen, [pacientët duhet t'i blejnë vetë]", thotë drejtoresha e spitalit rajonal në Mitrovicë, Luljeta Zhubi.
Në Prizren thonë se kanë mungesë të disa llojeve të penjve poliglaktikë (absorbues), kurse drejtori i Spitalit të Përgjithshëm në Pejë, Fazli Shala, edhe pse thotë se aktualisht në Pejë ka, "jo gjithmonë jemi të furnizuar 100 për qind".
Bujar Vitija, kryeredaktor në gazetën "Shneta", e cila raporton mbi sektorin e shëndetësisë në Kosovë, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se është e pakuptimtë mungesa e gjërave kaq bazike në spitale dhe klinika në ShSKUK. "Sa iu përket kërkesave të njësive për furnizime të ndryshme, ato bëhen me kohë, por vonesat po shkaktohen si rezultat i neglizhencës dhe papërgjegjësisë në administratën e ShSKUK-së dhe Barnatores Qendrore. ShSKUK-ja aktualisht ka buxhet sepse ka pranuar alokimin e fundit nga qeveria për tremujorin e katërt, megjithatë ka mungesë të materialeve dhe barnave. Kjo është e pakuptimtë dhe duhet të ketë më shumë përgjegjësi për këto mungesa", thotë Vitija.
Në bazë të Ligjit për Shëndetësi, ShSKUK-ja ka për detyrë që të ofrojë shërbime cilësore të kujdesit shëndetësor duke synuar performancë, efiçiencë dhe efikasitet sa më të lartë të shërbimeve për pacientët në pajtim me Ligjin për Shëndetësi. ShSKUK-ja është institucion unik shëndetësor dhe përbëhet nga institucionet e nivelit dytësor (sekondar) dhe tretësor (terciar) të kujdesit shëndetësor në sektorin publik të shëndetësisë si njësi organizative në pajtim me Ligjin për Shëndetësi.

## ShSKUK-ja synon thellimin e bashkëpunimit me Institutin për Endokrinologji "Vuk Vrhovac" në Zagreb




PRISHTINË, 18 NËNTOR - Ushtruesja e detyrës e drejtorit të përgjithshëm të ShSKUK-së, Pranvera Zejnullahu-Raçi, priti në takim endokrinologun nga Universiteti i Zagrebit, prof. dr. Zelko Metelko dhe prof. dr. Dario Raheliç, drejtor i Institutit për Endokrinologji - Diabetologji dhe Sëmundje Metabolike në Zagreb. Qëllimi i këtij takimi ishte thellimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në mes të Institutit për Endokrinologji "Vuk Vrhovac" dhe ShSKUK-së, përkatësisht Klinikës së Endokrinologjisë në QKUK, në drejtim të avancimit të kuadrove të kësaj klinike dhe mjekëve të rinj në specializim, sidomos në fushën e diabetologjisë dhe endokrinologjisë reproduktive.

INTERVISTË ME PUBLICISTIN MUAHMET MAVRAJ NË EMISIONIN E MBRËMJES INFONATA TË TËVË1, "VIZITA E MAVRAJT NË HAGË DHE EKSPOZITA E SELIMIT NË PRISHTINË" (16 NËNTOR 2022)

# Sakrifica e njerëzve tanë në Hagë është më e vogla që ata ishin dhe janë në gjendje ta bëjnë për Kosovën

## Qeveria po e stimulon spastrimin etnik të Kosovës

## Aleatët tanë po i humbim me gjuhën e pistë, - ata po kalojnë në retorikën e serbëve



*Intervistues:*
**Ardian VISOKA**

**InfoNata:** *… do të flasim për krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilët gjenden në qendrën e paraburgimit në Hagë për shkak të akuzave nga Gjykata Speciale. Ata vizitohen shpeshherë nga figura të shquara publike dhe njërin nga ata e kemi në studio. Z. Muhamet Mavraj mirëserdhët në studion e Info Nata!*
**Mavraj:** Mirë se ju gjeta! Faleminderit për ftesën!

**InfoNata:** *Nuk është kohë e gjatë që keni qenë në vizitë tek krerët e UÇK-së. Si ishin ata?*
**Mavraj:** Ata ishin shumë mirë dhe të fala të gjithë dashamirëve që pyesin për ta. Në fakt unë kam qenë më 1 tetor, me rastin e 25-vjetorit të protestave studentore këtu në Kosovë dhe terë ditën e kam kaluar me ta, pra përvjetorin e kam kaluar me ta. Ka qenë pak a shumë shenjë e përkujtimit të asaj date historike, shumë e çmuar dhe e vlerësuar nga ana e tyre dhe me tema e biseda të përgjithshme për fatin e gjykimit, procedurave, vështirësive, sfidave, kohës së lirë, poezisë, pikturës, ngapak politikës dhe kështu me radhë.

**InfoNata:** *Si është procedura për t'i vizituar, bëhet kërkesë? Si shkon i gjithë procesi para se të shkosh?*
**Mavraj:** Nuk është e vështirë procedura, por është e vështirë tani çështja e terminit sepse ka mjaft kërkesa. Unë e kam thënë në një postim timin (facebook) se ai vend atje është shndërruar në vend pelegrinazh të shqiptarëve të cilët vërshojnë atje nga e tërë bota, nga diaspora, nga Kosova, nga ShBA-ja nga Shqipëria, plotë miq, personalitete, shkrimtarë, shkrimtarë botërorë, gazetarë e kështu me radhë. Ndër ta edhe shumë bashkëluftëtarë. Është në pyetje, thjesht, koha e tyre dhe ngarkesat që ata i kanë, sepse siç e dini janë gjithnjë e më shumë materiale që po shkojnë atje,- materiale nga Serbia, dhe këta nuk është se i kushtojnë kushedi se çfarë rëndësie.

**InfoNata:** *Vazhdon që Serbia të dërgojë materiale?*
**Mavraj:** Patjetër se shumë. Numri i faqeve ka arritur në 1 milion, tani. Dhe nga vetë kjo ju mund ta nënkuptoni që bëhet fjalë për një obstruksion shumë të madh të Prokurorisë Speciale, e cila në mungesë të fakteve orvatet t'i mbajë në burg përmes zvarritjes së procedurave.

**InfoNata:** *Na shpjego pak po themi disponimin e gjithsecilit kur shkojnë dhe i vizitojnë njerëzit, duke filluar nga presidenti Thaçi dhe të gjithë bashkëluftëtarët e tij. Si ishte presidenti, si ishte Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi...*
**Mavraj:** Të gjithë janë shumë mirë, shumë-shumë mirë. Nuk qëndrojnë fare disa nga ato pëshpëritjet që flasin për lodhje, për rrezbitje ose për shkak të moshës e gjëra të tjera. Të gjitha janë gjepura. Ata janë të stërvitur nga jeta. Shkojnë atje nga një përvojë shumë-shumë e egër, nga një përvojë shumë-shumë e ashpër e jetës së tyre. Dhe vuajtja e dënimit ose qëndrimit në paraburgim për ta është një nga sakrificat më të lehta që ata mund t'i imagjinojnë.

**InfoNata:** *Kështu e thonë ata, është një nga sakrificat më të lehta?*
**Mavraj:** Ata e thonë dhe është përshtypja ime duke i njohur edhe përpara luftës, edhe gjatë luftës, edhe pasluftës, edhe tani në këtë proces që e përcjell me vëmendje shumë të thellë. Me të vërtetë kjo është një sakrificë shumë e vogël për ta në krahasim me atë që ata kanë qenë në gjendje ta bëjnë për Kosovën, që të gjithë ata. Një mijë herë kanë dalë të vdesin për këtë vend, për këtë komb, për Kosovën, dhe besoj se do ta bënin edhe në të ardhmen.




*E keqja është se po na ikun kuadro nga disa sektorë që i kemi deficit. Faktikisht do të ngelim pa disa specialistë të fushave mjaft kritike, siç është çështja e këtyre anesteziologëve. Kjo mund të jetë problem shumë i madh në të ardhmen, mund të vdesin njerëzit pa ta. Por, që të mos bëhem i tepërt, secili i ka sytë e vet, mendjen e vet, sheh, dëgjon... Këso atmosfere toksike, pavarësisht se nuk kam pritur asgjë prej kësaj qeverie, mund të them se nuk e kam paraparë deri në këtë shkallë. Thjesht, ajo që po ndodhë është një stimulim i heshtur i spastrimit etnik të Kosovës.*

**InfoNata:** *Si është një ditë e tyre në burg?*
**Mavraj:** Aq sa unë kam mundur të kuptoj, një ditë e tyre është e ngarkuar me vizita. Secili nga ta ka të drejtë dhjetë ditë vizita në muaj dhe në ato dhjetë ditë mund të jenë disa qindra veta, varësisht se si e organizojnë ose menaxhojnë kohën e vlefshme të vizitave. Kanë kohë për aktivitete të lira, kanë kohë për të përcjellë lajme, informohen, lexojnë, dëgjojnë dhe shohin disa kanale televizive, duke përfshirë disa kanale të Kosovës dhe Shqipërisë, pothuajse të gjitha kanalet shtetërore; diçka nga mediumet ndërkombëtare dhe kështu me radhë. Do të thotë është thjesht një dallim shumë i vogël nga qëndrimi këtu, veçse ne shkojmë e vijmë, ndërsa ata ngelin aty për një kohë.

**InfoNata:** *Një opinion i përgjithshëm që ata kishin për zhvillimet në Kosovë... Besoj se keni biseduar, nuk dua të hyjë në specifika....*
**Mavraj:** Shiko, pasi atë ditë ishte pak a shumë ditë festive as unë nuk kam dëshiruar e as ata nuk me kanë rënduar shumë me pyetje. Gjithsesi se është diskutuar për situatën e përgjithshme në Kosovë. Për shembull, Hashimi më tha se po përpiqet që të përcjellë sa më pak ngjarje ditore, lajme ditore, por kështu deri diku edhe të tjerët, edhe për të shmangur stresin nga zhvillimet e këtushme në Kosovë që sigurisht nuk janë më të mirat e mundshme, por edhe për ta ruajtur koncentrimin për materialet e tyre të procedurës.

**InfoNata:** *Ndërkohë, përveç materialeve të procedurës ata lexojnë edhe literaturë tjetër. Besoj që shkruajnë...*
**Mavraj:** Sigurisht që lexojnë edhe literaturë tjetër. Lexojnë




shkrimtarë botërorë, informohen për ngjarjet. Kanë mjaft mundësi, kanë mjaft kanale të informimit. Thjesht, siç kam thënë diku, ata më shumë informohen e bëjnë takime atje sesa ne që jemi të lirë këtu në Kosovë. Janë mjaft të informuar.

**InfoNata:** *Dua të flas për z.Rexhep Sleimin, i cili është duke e shpalosur edhe atë artisin edhe gjatë kohës sa është duke qëndruar në Hagë. Është folur për një numër të madh të pikturave dhe teksteve të këngëve që ka bërë...*
**Mavraj:** Faleminderit shumë që ia keni kushtuar kohën Rexhës. Do të thosha faleminderit edhe sikur të ishte në liri e lerë më tash që është i mbyllur atje. Me Rexhën kemi pasur një orë takim në atë vizitë, sepse koha tjetër pjesëtohej për pjesëtarët tjerë të paraburgosur atje, dhe shumicën e kohës na ka marrë biseda për poezinë, tekstet e këngëve dhe pikturën që ishte surprizë për mua, sepse nuk e kam ditur që Rexha i ka hyrë pikturës...

**InfoNata:** ***Nuk e keni ditur?***
**Mavraj:** Nuk e kam ditur sepse nuk është bërë llaf përpara. Për poezinë po, për tekstet e këngëve po. I etshëm të provojë gjera të reja, ndryshime, i kishte hyrë edhe pikturës dhe sa unë kuptova ende nuk e ka gjetur stacionin e vet. Ende është në kërkim të vetvetes. Si poezia ashtu edhe piktura thjesht si arte janë si gjuhë e dytë, gjuhë e tretë e komunikimit. Na thotë diçka me poezi, na thotë diçka me ngjyra, me ato përdredhimet estetike të ngjyrave dhe mbase, mbase

> *Ata e thonë dhe është përshtypja ime duke i njohur edhe përpara luftës, edhe gjatë luftës, edhe pasluftës, edhe tani në këtë proces që e përcjell me vëmendje shumë të thellë. Me të vërtetë kjo është një sakrificë shumë e vogël për ta në krahasim me atë që ata kanë qenë në gjendje ta bëjnë për Kosovën, që të gjithë ata. Një mijë herë kanë dalë të vdesin për këtë vend, për këtë komb, për Kosovën, dhe besoj se do ta bënin edhe në të ardhmen.*

mbrojtjen e vet është duke e ndërtuar nëpërmjet pikturës.

**InfoNata:** *Nëpërmjet pikturës?*
**Mavraj:** Ashtu e paramendoj.

**InfoNata:** *Është publikuar edhe një këngë me një tekst të ri të Rexhep Selimit. Kujtojmë tekstin e tij të famshëm "Kreshtat e Kosovës", atë këngën të cilën e këndojnë të gjithë nëpër dasma dhe ahengje familjare...*
**Mavraj:** Në fakt me e popullarizuara është kënga për Tahir Sinanin, por ai ishte duke krijuar edhe diçka tjetër atje. Ia lëmë kohës të mos i zbuloj këtu, por ato që m'i recitoi më pëlqyen shumë.

**InfoNata:** *Ai ka shkruar edhe më përpara...*
**Mavraj:** Ka shkruar më përpara, por tani ka kohë më shumë për të shkruar, për të reflektuar më shumë, sepse ma tha këtë fjalën 'reflektim'. Në fakt ai ma priti vetë se ka reflektuar thellë për të gjitha temat, përfshirë politikën, dhe në këtë kuptim, në kuadër të këtij refleksioni ai është duke krijuar tekste të cilat janë pak më sublime, më të herruara, më të ardhura dhe sigurisht më të fuqishme.

**InfoNata:** *Tekstet i shkruan kryesisht për luftën, dëshmorët dhe bashkëluftëtarët...*
**Mavraj:** Kryesisht për luftën, për dëshmorët, shokët dëshmorë, ata që i ka njohur ose ato ngjarje ku ai ka qenë i pranishëm dhe nuk janë thjesht trillime ose fantazi ose krijim nga fantazia e tij si krijues, por pak a shumë për ngjarjet dhe personalitetet që ai i ka njohur, prandaj kanë dalë edhe të fuqishme siç është teksti për Tahir Sinanin.

**InfoNata:** *Para se të hyjmë në studio biseduam për një vëllim me poezi të vitit 1994, mesa e kuptova...*
**Mavraj:** Po. Në fakt kur më pyesin për Rexhën, unë gjithmonë u tregoj se njohja ime fillestare me të është nëpërmjet poezisë në vitin 1994. Ka qenë një plejadë e poetëve të rinj në 94-tën, ndër ta edhe Rexhep Selimi, ku pati botuar librin e tij, "Grindje Rrokjesh" quhej. Kemi pasur një recensent të përbashkët dhe ma ka dhuruar atë libër, e kam lexuar me përkushtim, aq më shumë kur e dija se kush është dhe çfarë ideali ka brenda. Aty e gjeta edhe një program, një poezi programatike, nëse nuk gaboj "Vdekje në imagjinatë" që nuk me pëlqente si titull, por pastaj programi fliste për atë që ai e ka brenda vetes dhe për atë që ai e sheh në të ardhmen. Faktikisht, ai ishte përgatitur për të vdekur për Kosovën dhe njëfarë hallashtisje me jetën e vet, në fakt i thoshte jetës se vet që ia ka borxh rininë, buzëqeshjen, dashurinë, argëtimin dhe kështu me radhë dhe në fund,- ndjesë jetës se vet, sepse ishte djalë i ri, 23-24 vjeç në atë kohë,- sepse është i dashuruar në vdekjen e filan fistekut, një dëshmori antifashist që ka vdekur mbi tank, faktikisht. Kështu që, ajo fliste për gjithçka për vetë atë. Tutje, pastaj jeta e tij merr atë rrjedhë që e dimë të gjithë dhe jemi ku jemi tani.

**InfoNata:** *Ky libër gjendet akoma? Është menduar të ribotohet?*
**Mavraj:** Librat e vitit 1994 është vështirë të gjenden për gjithsecilin e asaj kohe, se kanë qenë 20-30 poetët të rinj, mjaft të talentuar në atë kohë. Ka qenë Valdet Berisha, Luzim Tafa, Sali Beqiraj, Beqë Cufaj, Harije Maksutaj, Habibe Maliqi, Elvira Durmishi, plotë e përplotë poetë të rinj në atë kohë. Ka qenë një shpërthim në atë kohë. Njerëzit e projektonin lirinë nëpërmjet poezisë. Një ndër ta edhe Rexha, megjithatë me poezi nuk çlirohej Kosova, kështu që shumë pak veta prej nesh pastaj kemi bërë vepra poetike.

**InfoNata:** ... *Frymëzohen të rinjtë për to...*
**Mavraj:** Sigurisht... Ato ishin shpërthimet e para të idealistëve, të njerëzve të rinj pa sherr që e kanë ndërmend thjesht të ia falin jetën këtij vendi.

**InfoNata:** ... *për pikturat. Ju thatë se është duke pikturuar që ta gjejë vetveten...*
**Mavraj:** Ishte përshtypja ime sepse unë nuk e pashë asnjë pikturë të vetme. Aty ishin 60 minuta dhe shkuan shumë shpejt, fluturuan. Përshtypja ime ishte që nga ato dhjetëra e dhjetëra piktura që ai i ka bërë...

**InfoNata:** *I kemi mbrapa në ekran edhe këto fotot e juaja që po qarkullojnë nga koha e luftës, takimet që i keni pasur...*
**Mavraj:** Po, këto janë të asaj kohe. Këto foto janë të 98-ës.

**InfoNata:** *Keni shkuar atje në cilësinë e gazetarit në atë kohë apo?*
**Mavraj:** Gazetarit, bashkëpunëtorit, si të doni. Të gjitha ngapak, por për shkak të gjyqit nuk dua të flasë për atë pjesë, por këto foto janë të 98-ës, diku në vjeshtë të 98-ës edhe nga veshjet siç i shohim. Këto janë në Novosellë diku, pastaj ngjitemi lartë në Berishë. Ka fotografi të tjera që janë në Shtab të Përgjithshëm të së njëjtës datë, por edhe datave të tjera të ndryshme. Atë fotografinë e ka ruajtur Rexha, atë tjetrën. Duket edhe këtë tjetrën ai ma ka dhuruar, ka qenë nga xhirimet e Nuhi Bytyqit, nëse nuk gabojë ose nga aparati i tij. Kjo është nga aparati. Këtë Rexha e ka ruajtur.

*Kështu siç po e shihni duke i poshtëruar kaq rëndë arsimtarët që kanë qenë kurrizi i shtetësisë së Kosovës në vitet më të vështira, asnjë komb nuk do të kishte të ardhme fatlume. Ushtria dhe arsimi kanë qenë dy shtyllat mbi të cilat është ngritur shteti i Kosovës.*




Ai ma ka dhuruar disa vite para se të bjerë në burg në Hagë.

**InfoNata:** *I ke këto fotografi, i mbanë?*
**Mavraj:** Po i kam tani dhe do t'i ruaj. Atëherë nuk i kam çmuar shumë, por tash kur i shoh nganjëherë ato, nga dhjetëra, qindra fotografi i shoh më të veçanta. Por ka fotografi që nuk i kam parë, kam harruar për to. Një natë me surprizoi njëri anëtar i Shtabit të Përgjithshëm me një foto. Nuk e kam ditur që e kam atë fotografi (qesh), ai xhemperi i kaltër që kam pasur ma përkujtoi pak a shumë edhe datën e përafërt kur kemi qenë atje. Këtu është "Çeliku" (Fatmir Limaj), "Dhjetëshi" (Rexhep Selimi), Nuhiu (Bytyqi) dhe unë. Këtu jemi në Novosellë.

**InfoNata:** *Si ishte t'i takoje në kohë lufte? Si ndiheshit?*
**Mavraj:** Njëjtë sikurse këtu.

**InfoNata:** *... Sepse në Prishtinë për shumë njerëz, UÇK-ja në fillimet e saj ishte si legjendë urbane dhe nuk besoj se kush ishte... Kishte shumë pyetje. Ju i keni pasur miq, i takonit...*
**Mavraj:** (Qesh). Shumë normale, sikurse këtu. Disa nga detyrat kanë qenë të ndara se kush atje, kush në Prishtinë dhe kush në vendet të tjera dhe kështu me radhë, por nuk do të flasë për atë pjesë.

**InfoNata:** *Mirë. Të pyeta disa herë për pikturat. Do të ketë një ekspozitë për pikturat. Janë disa piktura të selektuara që do të shfaqen në këtë ekspozitë dhe do të mbështetën nga Ministria e Kulturës. Kështu së paku qarkullojnë informacionet...*
**Mavraj:** Do të jetë ekspozitë që zgjatë, nuk do të jetë për një ditë dhe me sa di unë është për 110-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, tash festat e Nëntorit, përvjetori i daljes publike të UÇK-së, ku Rexha ka qenë njëri nga ata tre kryesorët, më 28 nëntor të vitit 1997.

**InfoNata:** *Në varrimin e mësuesit Geci...*
**Mavraj:** Po, në Llaushë.

**InfoNata:** *Dua të të pyes pak për z. Jakup Krasniqin, i cili është në moshë më i vjetri atje. Si ishte z. Krasniqi, i cili e ka lëshuar edhe një mjekër duke u bërë edhe në pamje më fisnik?*
**Mavraj:** (Qesh). I ngjan moshës, sigurisht. Zoti Jakup Krasniqi ka qenë shumë i rëndësishëm kur është kyçur në UÇK, sepse e ka inteletualizuar edhe më shumë fjalën publike në emër të UÇK-së dhe ia ka dhënë një stabilitet të mirë, një politikë stabile të atyre paraqitjeve. Ai gjithmonë ka qenë i kthjellët, e ka ditur gjithmonë se çfarë donë, pak hatërli, sigurisht, por shumë i informuar, i qetë dhe mjaft i mprehtë. Unë nuk pash asnjë lloj dallimi apo ndryshimi tek Jakup Krasniqi, pavarësisht moshës se shtyrë, tani, me 72 vjet. Madje-madje mu duk me i mprehtë në gjykim të situatës se përgjithshme, por edhe të rastit të tyre atje ku janë. Kënaqësi me nejtë më të dhe me shëndet ishte top dhe jo ashtu çfarë thonë, por shumë mirë me shëndet. Në pikëpamjen psikologjike, psiko-fizike ai dhe gjithë të tjerët qëndrojnë shumë-shumë mirë.

**InfoNata:** *Z. Mavraj sa mendoni se do të zgjasë ky proces?*
**Mavraj:** Po ta pyesim Prokurorinë Speciale, ky proces nuk kryhet kurrë, të paktën jo derisa vetë këta prokurorë të pensionohen. E kam thënë disa herë, nuk dua ta keqpërdoroj këtë studio, por nuk di term më të butë, ata janë një lloj mafie financiare atje. Prandaj, në mungesë të provave mundohen t'i dënojnë këta njerëz vetëm duke i mbajtur në paraburgim siç ka ndodhur me dhjetëra pjesëtarë të UÇK-së, sepse nuk ka fakte kundër tyre. Siç e dini asnjëri nga pjesëtarët e UÇK-së, anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm, nuk akuzohen për çfarëdo lloj krimi të kryer drejtpërdrejt, por vetëm për të ashtuquajturin zinxhir komandues, i cili ka rënë poshtë duke i gjykuar nivelet më të ulëta sesa Shtabin e Përgjithshëm dhe këtu kam parasysh komandantët e zonave, pastaj dy raste që kanë qenë në Tribunalin Penal Ndërkombëtar të Hagës, rasti Limaj dhe rasti Haradinaj,- i cili me 36 akuza, dy herë është shpallur i pafajshëm, pikërisht për shkak se ka dështuar zinxhiri komandues dhe jo ashtu siç përpiqen të tjerët ta paraqesin në lidhje me çështjen e dëshmitarëve. Ai është trillim dhe propagandë, krejtësisht. Tani kjo prokurori është plotësisht e vetëdijshme se nuk ka arritur ta gjejë asnjë fakt të vetëm që implikon cilindo, për çfarëdo lloj krimi, përjashtimisht për këtë shprehjen poetike të "zinxhirit komandues" ku asnjëherë nuk do të arrijë ta argumentojë. Ata e dinë se UÇK-ja ka bërë luftë të pastër, por thjesht si gjykatë politike që është e shfrytëzojnë në maksimum për përfitime të tyre financiare dhe për atë misionin e tyre politik që e kanë. Megjithatë, përshtypja ime është se shumë nga shtetet e Bashkimit Evropian edhe pse dikur kanë qenë të penduara që e kanë bombarduar Serbinë për t'i dalë krahë Kosovës, pas luftës në Ukrainë e kanë parë thjesht se kanë luajtur kot lojën ruso-serbe, e cila nuk do t'i shpie askund, sepse nuk e kanë bërë as Rusinë më të mirë dhe as Serbinë më të mirë, dhe as se ka kush ndërmend prej tyre t'i kthehet ndonjë kursi të paqes, përjashtimisht konflikteve, tensioneve të vazhdueshme dhe luftërave të armatosura përreth fqinjve të tyre.

## Aleatët tanë po i humbim me gjuhën e pistë, - ata po kalojnë në retorikën e serbëve

**InfoNata:** *Z. Mavraj, shpresoj se Gjykata Speciale do të jetë më e shkurtër dhe këta të dëshmojnë pafajësinë e tyre dhe të kthehen në Kosovë. Dua të flasë pak edhe për aktualitetin politik që e kemi në vend. Situatë e komplikuar më sa duket sidomos pas zhvillimeve të ditëve të fundit, me daljen e Listës Serbe nga institucionet, vendimi për targat, kërkesën e faktorit ndërkombëtar që të shtyhet një vendim i tillë dhe për takimet në Bruksel dhe Uashington të lidershipit kosovar, të qeverisë dhe opozitës. Si i ke parë të gjitha këto zhvillime...*
**Mavraj:** Nuk e di sa kemi tash minuta...

**InfoNata:** *Kemi mjaftueshëm sa për t'i diskutuar...*
**Mavraj:** Shkurtimisht po i them. Është një situatë shumë e brishtë, larg asaj që ka mundur të jetë paksa më e mirë, më e qëndrueshme edhe në planin e brendshëm, në kuptimin e mirëqenies, të shtresave të ndryshme të shoqërisë dhe zhvillimit që nuk është askund hiç, por edhe në planin e jashtëm ku jemi duke pësuar debakël pas debakli. Për fat të keq fusha e diplomacisë së Kosovës është krejtësisht shkret me përjashtime të vogla, raste të vogla, të diplomatëve të vjetër që kanë ngelur dhe i ruajnë disa lidhje, i bëjnë disa lobime, por nuk janë afër qendrave të vendosjes, janë larg. Tani avancimi i Serbisë në këtë plan ka qenë i pritshëm. Ata kanë pasur diplomaci aq të fortë saqë e kanë bindur Evropën se në Kosovë janë kryer edhe trafikime me organe njerëzore dhe si rezultat e kemi këtë gjykatë që e kemi. Po kështu edhe tani, gradualisht duke i shfrytëzuar dobësitë e politikës tonë, diplomacisë tonë, gjithnjë e më shumë, tani edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës i ke unison me gjuhën e Beogradit që është fatkeqësi dhe kjo po ndodhë për herë të parë, ndoshta pas Luftës së Parë Botërore, pas 100 vitësh. Ky është një dështim i madh i Kosovës, sepse aleatët tanë po kalojnë në retorikën e regjimit të Beogradit. Tani fajtorët mund t'i kërkojmë gjithë ditën, por në

fund të ditës nuk kanë kurrfarë rëndësie, ka rëndësi realiteti në të cilin është Kosova këtu, tani, aktualisht. Por, e di se për asgjë, për pak angazhim dhe për pak vetëpërmbajtje të fjalorit të pistë ne po e humbim, po rrëshqasim prej përkrahjes së ShBA-së, që për neve, thjesht mund jetë kob i zi për të ardhmen e Kosovës. Kështu siç po rrjedhin tani gjërat, pa dashur të fajësojë ndokënd dhe pa ngritur askënd, përshtypja ime është se e tëra është propagandë në politikën tonë sepse nuk do të ketë njohje reciproke me Serbinë, pra të ndërsjellë, as të njëanshme, as njohje në qendër të planit, as njohje në periferi të planit, madje, kam thënë dhe e përsërisë, as në margjina të asnjë plani, madje s'ka plan fare, hiç.




*Po kështu edhe tani, gradualisht duke i shfrytëzuar dobësitë e politikës tonë, diplomacisë tonë, gjithnjë e më shumë, tani edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës i ke unison me gjuhën e Beogradit që është fatkeqësi dhe kjo po ndodhë për herë të parë, ndoshta pas Luftës së Parë Botërore, pas 100 vitësh. Ky është një dështim i madh i Kosovës, sepse aleatët tanë po kalojnë në retorikën e regjimit të Beogradit.*

## Janë duke e mjeshtëruar ngrirjen për të ardhmen e largët të çështjes së Kosovës e cila është interes strategjik ruso-serb

**InfoNata:** *S'ka plan?*
**Mavraj:** S'ka plan fare hiç. Ka skicë e cila thjesht është duke qarkulluar prej zyre në zyrë. Po e mbajnë msheftë për qytetarëve, ... disa vija të trasha, pak a shumë që i dimë të gjithë se cilat janë dhe cilat nuk janë,- ajo që e kërkon Kosova me dekada... dhe (këto vija) nuk përbëjnë mbylljen e tensioneve ose konflikteve ose mospajtimeve Kosovë-Serbi. Thjesht, janë duke e mjeshtëruar ngrirjen për të ardhmen e largët të çështjes së Kosovës e cila është interes strategjik ruso-serb, st-r-a-t-e-gj-i-k ruso-serb.

**InfoNata:** *Pra sa më shumë që të vonohet i shkon përshtati edhe serbëve edhe rusëve?*
**Mavraj:** Edhe serbëve edhe rusëve. Rusëve për arsye të tyre, jo pse e duan Serbinë, dhe Serbisë për shkak se është e bindur nga mësimi historik që e kanë nxjerrë pas pushtimit të Turqisë, pastaj dy pushtimeve të tjera që kanë qenë në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore, ajo sërish e sërish e sërish është kthyer dhe shpreson se do të kthehet sërish këtu, të paktën atje ku ajo e konsideron kishë të vërtetë të veten që është veriu i Kosovës. Prandaj, potezat tanë nuk duhet të bëhen më pa i menduar edhe potezat e kundërshtarit sepse asgjë të mirë për Kosovën nuk kanë menduar ata duke i tërhequr serbët nga institucionet e Kosovës dhe duke pritur edhe një "gabim" tjetër për t'i tërhequr edhe nga komunat tjera...

**InfoNata:** *... nuk është parashikuar kjo...*
**Mavraj:** Mendoj se këta ose nuk e kanë parashikuar se janë shumë të dobët ose janë krejtësisht në linjë me strategjinë ruse, e cila thjesht është gjithçka në gjendje të shpikë vetëm për ta mbajtur sa më zvarrë tensionin në Ballkan, jo vetëm në Kosovë. E kam thënë edhe diku tjetër, tensioni i serbëve është në ekspansion edhe në Kosovë, edhe në Mal të Zi, edhe në Bosnje dhe brenda vetë Serbisë ku përfiton aq shumë ndihma dhe askush nuk merret me demilloshevikizimin e Serbisë, denazifikimin e Serbisë. Sa më shumë që po e ndihmojnë Serbinë aq më agresive po bëhet dhe ajo e ka zënë këtë pozicion dhe po përpiqet që të ushqehet nga të katër anët e botës, gjë që edhe po ia arrin, në radhë të parë për shkak të dobësive historike të BE-së, të Evropës në tërësi, për shkak të dobësive tona gjithnjë më të mëdha dhe dështimeve tona k-o-l-o-s-a-l-e në politikën e jashtme dhe në diplomacinë e Kosovës, por edhe në politikën e brendshme ku, faktikisht, le ta quan kush qysh të dojë, ne jemi duke kryer një vetëspastrim etnik, sepse kjo ikja masive e njerëzve, 20 e kusur vite pas lirisë së Kosovës është thjesht tragjedi...

## Ikjet masive nga pasiguria për të ardhmen

**InfoNata:** *E kemi mbytur shpresën në Kosovë?*
**Mavraj:** E kanë pritur si shpresë ardhjen e kësaj qeverie, atëherë me atë 6 tetorin e 2019-ës, pastaj ndodhi ai depresioni ekonomik, ndodhi pandemia, ndodhi gjithçka dhe programet kanë qenë tërësisht dekurajuese dhe tani sjellja dhe politika e kësaj qeverie janë dekurajuese madje edhe për njerëzit që edhe ashtu janë të punësuar dhe ikin nga Kosova. Kam përmendur edhe disa shembuj konkretë. Kam dhjetëra shembuj konkret (nga kontaktet personale) por për mendimin tim rasti më domethënës është rasti i një biznesi 100-vjeçar në Prishtinë, i cili ka disa biznese këtu në Prishtinë (Kuzhina Popullore "Opoja") dhe mendon ta braktisë Kosovën, me shit biznesin dhe me ik krejt prej Kosovës sepse dy djemtë nuk po i rrinë këtu. "Po pse nuk po të rrinë ty djemtë këtu"? –"Sepse nuk po shohin siguri për të ardhmen e fëmijëve të tyre". Ose, rastin që e kam përmendur, të një kandidati për doktor shkence, thjesht është berber. Duke qenë kandidat për doktor shkence ka dy binjak dhe tani i pret dy bineq tjerë edhe ai ka filluar të ndiejë ankthin si prind i ardhshëm se ku ka me i rritë këta binjakë që po i krijon këtu në Kosovë. E përplot raste të tjera. Përvojat nga sallat e provimeve, të ligjëratave që thjesht shpirtin ta shkrumbojnë kur i sheh me 5-1, 6-1, 7-1 raportin vajza me djem. Rinia jonë thjesht po ikë dhe faktikisht ata po i përdorin si skllevër atje larg, ndoshta për letra, dhe si skllevër seksual që ndoshta s'e thotë askush dhe këtuhja po mbetet shkretë gjithmonë e më shumë. Një biznesi të rëndësishëm Banka Botërore ia refuzoi kredinë për shkak se në vitin 2028 ata parashohin që do të jenë vetëm 800 mijë banorë në Kosovë, e thotë Banka Botërore. Dhe i kanë thënë se nuk ke mundësi të zhvillimit të biznesit me ikjen e substancës, të cilës i kushtohet biznesi në fjalë.

**InfoNata:** *Nga qeveria thuhet se ky problem nuk është vetëm i Kosovës, thuhet se është edhe problem rajonal. Po ikin edhe grekët, edhe qytetarët shqiptarë nga Shqipëria, po ikin nga Maqedonia, Mali i Zi...*
**Mavraj:** Ashtu, ashtu. Sa herë që këta duan ta zbusin apo ta relativizojnë si problem, e ky nuk është problem, është tragjedi, ata shkojnë, gjithkush shon merr shembuj nga dynjaja. Është e vërtetë, por qeveritarët harrojnë me përmend se edhe brenda vetë Bashkimit Evropian (BE) lëvizin qytetarët evropianë brenda një shteti në tjetrin, por edhe brenda Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) ka migracion të brendshëm sa të duash, por këtu (rasti i Kosovës) muhabeti është krejtësisht tjetërfare. Këtu është Kosova që ende nuk është rehatuar si shtet, ende nuk jemi anëtar të OKB-së, ende nuk jemi në NATO, ende nuk jemi në BE dhe ende nuk jemi në Këshillin e Evropës. Nuk jemi askund hiç dhe s'e ka mendjen me këta njerëz askund hiç të anëtarësohet dhe asgjë nuk kemi me arritë, vetëm poshtë e më poshtë kemi me shku. Kjo është tragjedi kombëtare.

## Stimulim i heshtur i spastrimit etnik të Kosovës

**InfoNata:** *Çfarë duhet të bëjmë? Duhet të ketë një rizgjim të qytetarëve sepse kemi mjaft parti politike të cilat i kemi provuar...*
**Mavraj:** ...Sepse në qoftë se këtu kemi mjaftë mjekë dhe çdo ditë na ikin ndër sy dhe ti shkon gjoja me sjellë kuadro nga jashtë, këta këtu e marrin mesazhin se janë të tepërt dhe po ikin. E keqja është se po na ikun kuadro nga disa sektorë që i kemi deficit. Faktikisht do të ngelim pa disa specialistë të fushave mjaft kritike, siç është çështja e këtyre anesteziologëve. Kjo mund të jetë problem shumë i madh në të ardhmen, mund të vdesin njerëzit pa ta. Por, që të mos bëhem i tepërt, secili i ka sytë e vet, mendjen e vet, sheh, dëgjon... Këso atmosfere toksike, pavarësisht se nuk kam pritur asgjë prej kësaj qeverie, mund të them se nuk e kam paraparë deri në këtë shkallë. Thjesht, ajo që po ndodhë është një stimulim i heshtur i spastrimit etnik të Kosovës.

**InfoNata:** *Spastrim etnik i pavullnetshëm sepse nuk besoj se Qeveria e Kosovës është e interesuar...*
**Mavraj:** Kur kthehet në trend është vështirë të ndalet. Kur bëhet trend diçka është vështirë me ndalë qoftë edhe për ta sjellë një parti me 50 për qind në pushtet. Kur bëhet trend me lëshu vatanin është vështirë edhe me ndalë. Kur ka qenë në trend me ardhë për të luftuar s'ka pasur kush që e ndalë të riun, kanë ardhur njerëzit për të luftuar. Por, ky trend aktualisht është nga me të këqijtë e mundshëm që ka mundur ëndërr ta shohë Kosova.

**InfoNata:** *Historikisht...*
**Mavraj:** Ky moment, kur të vjen në bilanc kemi për ta parë, është shumë-shumë me keq në çdo plan, edhe në plan ekonomik, edhe në plan demografik, edhe në çfarëdo lloj plani, përshirë edhe këtë planin psikologjik, ku secili është nervoz, duhet të maten fjalët mirë se çfarë po flet me tjerët, reagojnë me nervozë. Secili e ndjenë që e ka gjithmonë gjendjen më të rënduar në jetën e tij...

**InfoNata:** *... jetohet në pasiguri të madhe...*
**Mavraj:** Është pasiguri shumë e madhe. Po të them se kur një biznes 100-vjeçar nuk sheh siguri këtu, dikush duhet të ia qesë gishtin kokës, t'i thotë zotëriut prit pak, ndalë. Dhe këtë kandidatin për doktor shkence që e përmenda e që është berber dikush duhet ta vizitojë dhe t'i thotë prit pak se nuk je për berber, as të largohesh, por t'i duhet të vish të punosh në këtë institucion dhe kështu me radhë. Janë gjëra, janë ngjarje që po ndodhin para syve tanë, para hundëve tona dhe më nuk mund të hesht.

**InfoNata:** *Me arsimin çfarë po bëjnë?*
**Mavraj:** Kështu siç po e shihni duke i poshtëruar kaq rëndë arsimtarët që kanë qenë kurrizi i shtetësisë së Kosovës në vitet më të vështira, asnjë komb nuk do të kishte të ardhme fatlume. Ushtria dhe arsimi kanë qenë dy shtyllat mbi të cilat është ngritur shteti i Kosovës.

**InfoNata:** *Z. Mavraj faleminderit shumë që ishit sonte në studion e Info-Natës.*
**Mavraj:** Respekt, faleminderit edhe prej jush!

# Ministrja Hajdari: Përkrahja e ndërmarrësisë, faktor kyç për zhvillimin ekonomik



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) ka organizuar një bashkëbisedim me ndërmarrësit vendorë dhe palët e tjera të interesit, me temën “Ndërmarrësia dhe rritja e qëndrueshme ekonomike”.
Në shënjim të Javës Globale të Ndërmarrësisë, MINT ka organizuar këtë ngjarje me qëllim të diskutimit me ndërmarrësit vendorë, shoqatat industriale dhe akademinë, për politikat dhe instrumentet përkrahëse qeveritare për ndërmarrjet fillestare, të vogla dhe të mesme, gjersa sektori privat është kontribuues kryesor për rritjen e qëndrueshme ekonomike.
Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka thënë se fusha e ndërmarrësisë ka rëndësi të madhe dhe vendimtare për rritjen e qëndrueshme ekonomike të vendit. “Unë personalisht besoj në ju ndërmarrësit tanë, sepse ju jeni ata që mund ta ndryshoni mënyrën se si jetojmë dhe punojmë. Me sukseset dhe revolucionet e juaja, ju përveçse krijoni pasuri nga ndërmarrësia, ju krijoni edhe vende pune dhe kushte për një shoqëri të lulëzuar dhe ekonomi të qëndrueshme në republikën tonë. Për më shumë, ju jeni liderët e inovacionit teknologjik, që sjellin në treg produkte apo shërbime inovative dhe teknologji të re, që kontribuojnë në rritjen e konkurrueshmërisë suaj në treg dhe arritjen e synimit tonë për transformim të industrisë vendore në një industri më të integruar globalisht”, ka theksuar Hajdari.
Gjersa zhvillimi i ndërmarrësisë nxit inovacionin, krijon vende pune dhe kontributet e ndërmarrësve mbrojnë sistemin social, ministrja Hajdari ka thënë se zhvillimi i ndërmarrësisë është në fokus të programit të Qeverisë së Kosovës dhe Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.
Duke i njoftuar të pranishmit për proceset e hartimit të politikës kombëtare për zhvillim industrial, inovacion dhe ndërmarrësi nën udhëheqjen e MINT, ajo solli në vëmendje se shkëmbimi i ngushtë dhe i vazhdueshëm midis politikës dhe biznesit është thelbësor, veçanërisht tani në këto kohë sfiduese, pasi kostot socio-ekonomike po bëhen gjithnjë e më të dukshme për shkak të rritjes së çmimeve të energjisë, zinxhirëve të ndërprerë të furnizimit, varësive të dhimbshme për lëndët e para të cilat ndërmarrjet tona po i përjetojnë drejtpërdrejt.

# Kontrabandë me naftën?, Shqipëria importon më pak se Kosova dhe Maqedonia e Veriut




Prishtinë, 18 nëntor - Tregu i karburanteve është një ndër më të mëdhenjtë në Shqipëri dhe dukshëm nga shifrat më i pakontrolluar. Një vit më parë Shqipëria me një popullsi prej 2.7 milionë banorësh, sipas të dhënave zyrtare, importoi 611.1 mijë ton naftë. Ndërsa numri i mjeteve sipas Instatit llogaritet për vitin 2021 në 740.6 mijë ton në të gjithë vendin. Por, nëse e krahasojmë me vende të rajonit si Kosova e Maqedonia e Veriut, Shqipëria rezulton se ka importuar mijëra tonë më pak karburante.
Kosova me vetëm 397.9 mijë mjete, gati sa gjysma e atyre në Shqipëri ka importuar vitin e kaluar 792.3 mijë tonë karburante. Njëlloj rezulton edhe me Maqedoninë e Veriut që vjet importoi 839.6 mijë tonë karburante në një kohë që në numri i mjeteve llogaritet në 559.4 mijë të tilla.
Referuar këtyre të dhënave, me një numër të tillë automjetesh dhe këtë sasi karburanti të deklaruar dukshëm Shqipëria nuk e plotëson kërkesën për naftë.
Kjo ngre pikëpyetje dhe shton hije dyshimi se kjo pjesë mbulohet me karburant kontrabandë. Humbjet për shtetin në këtë rast do të ishin të konsiderueshme me të ardhura të munguara për këtë mall akcize. E, në fakt, vetë ministrja e Financave, Delina Ibrahimaj, pak ditë më parë në Komisionin e Ekonomisë pranoi mungesën e kontrollit për sektorin e hidrokarbureve. Ajo ka deklaruar se gjurmimi i karburanteve po mbahet pezull, pasi shteti është në një proces gjyqësor me një kompani private, e cila ka hedhur në gjykatë vendimin e Këshillit të Ministrave për këtë proces. / Top Channel

## KEDS-i i informon nxënësit sesi duhet të kursehet energjia elektrike

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Projekti për kursimin e energjisë elektrike për nxënësit e klasave IV dhe V këtë radhë ka vazhduar në shkollat “Ismail Qemali” dhe “Pavarësia” të kryeqytetit.
Drejtoresha e shkollës “Ismail Qemali” në Prishtinë, Mimoza Krasniqi, ka përgëzuar KEDS-in për këtë iniciativë, duke thënë se nxënësit morën informata bazë dhe shumë të vlefshme që edhe ata të kontribuojnë dhe t’i praktikojnë këto këshilla kursimi në shkollë dhe shtëpi.
Një tjetër falënderim për KEDS-in ishte nga drejtori i shkollës “Pavarësia”, Shefki Rusinovci, i cili tha se kjo ligjëratë ishte shumë e nevojshme për nxënësit të cilët është mirë të informohen dhe vetëdijesohen sa më shumë për kursimin e energjisë elektrike. “Nëse këta fëmijë kur të shkojnë në shtëpi kanë për të reflektuar me këshillat e marra sot, për prindërit është dhurata më madhe nga ta. Falënderoj edhe njëherë KEDS-in!”, ka thënë ai.
KEDS-i ka bërë me dije se do ta vazhdojë projektin edhe në komuna të tjera të vendit.



# Si kanë ndikuar nomadët në formimin e qytetërimit tonë

Nga Anthony SATTIN



Një i ri ecën drejt meje me një kërrabë të varur mbi shpinë. Një tufë delesh ecin pranë tij, dhe e marrin për nga shtegu si një turmë fëmijësh të zhurmshëm. Një burrë i moshuar i ndjek nga pas, i lodhur nga vitet që ka mbi shpinë, por që ende mbahet, me një pushkë mbi supin emajtë.

Ai përdor gjuhën e tij fisnore për të drejtuar kopenë. Pas tij vijnë 2 gra të hipura mbi 2 gomerë. Mendoj se janë gruaja dhe vajza e tij. Ato duken së jashtmi si gra të forta. Gjithsesi jeta është e vështirë nën majat e maleve Zagros në Iranin perëndimor. Disa gomerë të tjerë bartin sendet e tyre, të grumbulluara brenda një harari të madh ngjyrë kafe, që është thururnga gratë, dhe që shumë shpejt do të ripërdoret si një strehë në hyrjes së tendës së tyre të ndërtuar me lëkurë dhie.

Në këto lartësi ka shumë pak pemë. Por bora ka shkrirë, dhe dominojnë kullotat me bar dhe shumë të shumëllojshme. Familja buzëqesh ndërsa zhvendos delet dhe dhitë e saj përgjatë shtegut që gjarpëron drejt terrenit shkëmbor. Edhe unë u buzëqesh, i pushtuar nga emocioni i migrimit vjetor të fisit Bakhtiari nga fushat e ultësirës në male, në kërkim të kullotës verore. Këtu kudo është bukur. Rrezet e pjerrëta të diellit ngjyrosin malet ngjyrë rozë, dhe veshin si me ar gjithë sipërfaqen e përroit. Gjatë dy ditëve në vijim, familja nomade më njohu me luginën dhe njerëzit e fisit të tyre.

Ata më treguan për jetën e tyre, tokat fisnore, kafshët që mbarështojnë, fëmijët për të cilët kujdesen. A duhet t'i dërgojnë ata në një shkollë me konvikt shtetëror, apo t'i rrisin si nomadë pa asnjë arsimim bazë? Por edhe për shumë sfida të tjera, me të cilat përballet një komunitet baritor në shekullin XXI-të

Unë kam dëgjuar histori të ngjashme nga beduinët dhe berberët në Afrikën e Veriut dhe Lindjen e Mesme, ku kam kaluar shumë vite. Nga Tuaregët dhe Uodabit tek shtëpitë dhe bibliotekave prej balte të Timbuktusë. Nga Masait që jetojnë nëpër shkurret e kuqe të Afrikës Lindore; tek nomadët që jetojnë në buzë të shkretëtirës Tar në Indi.

Me të gjithë ata, biseda priret të fokusohet mbi të njëjtën çështje:atë të vazhdimësisë, të krenarisë për përkatësinë, mbi të qenit në harmoni me mjedisin e tyre, dhe të respektimit të asaj që ofron natyra. Gjithashtu, edhe tek vështirësitë e të bërit një jete nomade, sidomos kur qeveritë duan që të nguliteni në një vend të caktuar.

Këta njerëz më kujtojnë harmoninë që ka ekzistuar midis njeriut dhe botës natyrore. Ata e njohin mjedisin e tyre në një mënyrë që mund të fitohet vetëm nëpërmjet të jetuarit në kushte të barabarta me botën natyrore, dhe jo në dominim. Banorët e fisi Bakhtiar në Iranit, e dinë rëndësinë që ka toni i blegërimës së kafshëve që kanë në tufat e tyre. Ata e kuptojnë kur kafshët janë të kënaqura, të uritura apo të kërcënuara. Ashtu siç dinë të lexojnë retë dhe aromat që përhapin erërat. Sa më shumë i shoh dhe dëgjoj, aq më shumë më kujtohet se ne të gjithë kemi jetuar dikur në këtë mënyrë. Rrënjët e fjalës "nomad" gjenden tek gjuhët e hershme indo-evropiane.

Ajo buron nga fjala nomos, e cila mund të përkthehet si "një zonë fikse ose e kufizuar" ose "kullotë". Nga kjo fjalë-rrënjë u kaluan tek nomas, që do të thotë "një pjesëtar i një fisi baritor endacak", dhe që nënkupton "dikë që kërkon një vend për të kullotur kopetë e tij".

Më vonë, pasi u ndërtuan qytete dhe fshatra, dhe më shumë njerëz u vendosën përgjithmonëdiku, fjala nomad nisi të përshkruajë ata që jetonin pa mure rrethuese dhe përtej kufijve. Sot termi nomad përdoret nga njerëzit në dy mënyra shumë të ndryshme. Për disa nga ne, kjo fjalë bart një ndjenjë nostalgjie romantike.

Por shumë shpesh mbart një gjykim të nënkuptuar, se njerëz të tillë janë hajdutë, emigrantë, endacakë, njerëz në lëvizje e sipër apo edhe në arrati. Pra janë njerëz që nuk i njohim. Kjo e fundit, ka bërë që njerëzit që kanë një banim të përhershëm diku, të hedhin poshtë arritjet e popujve nomadë.

Edhe pse ne priremi ta shohim ndryshe historinë e tyre, historia e popujve nomadë nuk është as më pak e mrekullueshme dhe as më pak domethënëse se ajo e popujve që u ngulitën dikur përgjithmonë. Historitë e tyre të ndryshme dhe të jashtëzakonshme, janë vendosur në disa nga peizazhet më ekstreme të botës, dhe përgjatë një linje kronologjike që shtrihet që nga koha e fillimit të arkitekturës monumentale, në Gobekli Tepe në Turqi rreth vitit 9500 para Erës Sonë.



Kontributet e tyre kanë qenë thelbësore në marshimin e asaj që shumë historianë tradicionalisht e kanë quajtur qytetërim. Marrin rastin e Pars, një fis nomad indo-evropian që doli nga stepat e mëdha euroaziatike, dhe që u vendos në pllajën malore ku sot shtrihet Irani.

Nën një udhëheqës dinamik si Kiri në shekullin VI Para Erës Sonë, Pars vendosi kontrollin e një territori të madh nga Maqedonia deri në Luginën Indus, dhe nga Omani në gadishullin arabik dhe deri në Detin e Zi. Pra ai sundonte mbi rreth 40 për qind të popullsisë së botës.

17 vjet pas vdekjes së Kirit, një nga pasardhësit e tij, Dari I, një burrë nomad, mbretëria e të cilit nuk kishte qytete, ndërtoi një lloj të ri monumenti, të cilin grekët e lashtë e quanin Persepolis. Qyteti i fisit Parsi nuk ishte qytet siç e kuptojmë ne këtë fjalë. Dari nuk jetonte atje.

Përkundrazi, Persepolis shërbeu si një seli e shenjtë, ceremoniale dhe diplomatike e perandorisë së tij, por edhe si vendi ku ruheshin thesaret e tij. Ngritja e platformës së madhe prej guri përpara një vendi të shenjtë të quajtur Mali i Mëshirës, ishte një akt i shenjtë. Çdo vit me rastin e Sulltan Nevruzit, Viti i Ri Persian, 27 fiset dhe kombet të mbretërisë dërgonin përfaqësuesit e tyre me sasi të mëdha ar, kuajsh, liri dhe dhurata të tjera.

Por stilet arkitekturore të Persepolis u kopjuan nga Egjipti. 400 vjet më vonë, në shekullin II Para Erës Sonë, pasi Republika Romake e mundi Kartagjenën dhe u bë dominuese e Mesdheut, dhe ndërsa Kina po lulëzonte nën Perandorin Han Vu, tregtia nisi të zhvillohej përgjatë Rrugëve të Mëndafshit pikërisht nëpër territoret e gjera nomade, midis Lumit të Verdhë në Kinë dhe Evropës.

Këta popuj nomadë kishin të përbashkët një atdhe, nëpër të cilin bridhnin me karroca të ngadalta dhe me rrota të rënda, duke drejtuat kuajt dhe bagëtitë në kërkim të kullotave. Përkundër pretendimit se nomadët e hershëm ishin primitivë dhe të izoluar, ne e dimë nga varret e udhëheqësve e tyre, se ata visheshin me rroba mëndafshi kinez, të zbukuruara me qimet e gatopardit.

Po ashtu uleshin në qilima persiane, përdornin xhamat e shpikur nga romakët, dhe prodhonin bizhu shumë të holla nga ari grek për të dekoruar veten dhe kuajt e tyre. Dhe nga këtu buronhipoteza që këta nomadë të ishin zotërit e një bote tregtare që solli mallra dhe tradita kulturore nga Deti i Kinës Lindore deri në brigjet e Oqeanit Atlantik në Perëndim.

Dhe mos harroni nga Lindja e Mesme erdhën ari, perlat, erëzat, kurat mjekësore, instrumentet muzikore, çeliku i farkëtuar dhe pëlhurat e qëndisura me ar. Nga Rusia erdhën argjendi, qelibari, gëzofët dhe luftëtarët. Nga Koreja, lëkurat e lundërzës dhe letra. Nga Evropa, leshi, shpata dhe qelqi. Dhe nga Kina mëndafshi dhe porcelani, midis shumë produkteve të tjera. Rivlerësimi i "gjysmës tonë endacake", na lejon të shohim se çfarë kemi mësuar nga njerëzit që jetojnë gjithnjë në lëvizje, dhe se sa shumë kemi përfituar nga bashkëpunimi. Po ashtu na lejon të shohim një mënyrë tjetër jetese, shumë të shkathët, fleksibël dhe në ekuilibër me natyrën.

Shënim: Anthony Sattin, autor i disa librave të njohur mbi historinë dhe udhëtimet, përfshirë "Portat e Afrikës" dhe "Lorenci i Ri". Një anglo-amerikan, ai jeton midis Londrës, Anglisë dhe Italisë.

*Marrë me shkurtime nga "Smithsonian Magazine" – Bota.al*




# Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

## Komiteti Paraolimpik për herë të parë në Asamblenë e Berlinit



PRISHTINË, 18 NËNTOR - Lëvizja Paraolimpike e Kosovës (LPK) për herë të parë është pjesë e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Komitetit Paraolimpik Ndërkombëtar që po mbahet në Berlin të Gjermanisë nga 16 deri më 18 nëntor. Në këtë eveniment sportiv vendin tonë po e përfaqësojnë presidentja e Komitetit Paraolimpik të Kosovës, Njomza Emini dhe zëvendëspresidenti Daut Tishuki. "Asambleja gjenerale e jashtëzakonshme e Komitetit Paraolimpik Ndërkombëtar, ndër të tjera, do të shqyrtojë: Statusin e Komiteteve Paraolimpike të Rusisë dhe Bjellorusisë; draftin e Planit Strategjik të Komitetit Paraolimpik Ndërkombëtar 2023-2026 si dhe prezantimin e ndryshimeve në Bordin Drejtues të këtij Komiteti", thuhet në njoftimin e Komitetit Paraolimpik të Kosovës.

Po në këtë njoftim thuhet se presidenti i IPC-së, Andrew Parsons, KSHE Mike Peters dhe shefja për Anëtarësim dhe Ndikim, Kristina Molloy, para të pranishmëve do ta paraqesin raportin e përditësuar rreth përparimit të arritur për këtë vit. "Pas shumë angazhimeve dhe fazës së riorganizimit të Lëvizjes Paraolimpike të Kosovës, Bordi Ekzekutiv i IPC këtë vit pranoi në radhët e tij Komitetin Paraolimpik të Kosovës me status të përkohshëm, që nënkupton se gëzojmë të gjitha të drejtat sikurse komitetet e tjera paraolimpike kombëtare përveç të drejtës në votim. Vitin e ardhshëm presim të bëhemi anëtar me të drejta të plota, që nënkupton edhe pjesëmarrjen e parasportistëve të Kosovës në Lojërat Paraolimpike Parisi 2024, me çka do të realizohet ëndrra sublime e sportistëve me aftësi të kufizuara", thuhet në njoftimin e Komitetit Paraolimpik të Kosovës. Presidentja Emini dhe zëvendëspresidenti presidenti Tishuki do ta shfrytëzojnë praninë e tyre në këtë asamble për takime me krerët më të lartë të Lëvizjes Paraolimpike Ndërkombëtare, por edhe për takime me komitetet homologe për ta promovuar edhe më tepër Lëvizjen Paraolimpike të Kosovës.

## Kosova dhe Shqipëria zhvillojnë ndeshjet e fundit për këtë vit

"Epoka e re"

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll dhe Kombëtarja e Shqipërisë i zhvillojnë sot (e shtunë) i zhvillojnë ndeshjet e fundit për këtë vit. "Dardanët" që luajtën 2-2 ndaj Armenisë ditë më parë në stadiumin "Fadil Vokrri" kësaj radhe e presin Ishujt Faroe dhe në këtë ndeshje Kosova synon fitore në mënyrë që të mbyll vitin në mënyrën me të mirë dhe të bëjë përgatitjet për vitin e ardhshëm. Trajneri Alain Giresse pas ndeshjes me Armeninë ka thënë se rendësi ka fakti se "dardanët" nuk humben, përderisa për lojtarët e rinj të ftuar në përfaqësuese do të deklarohet pas ndeshjes ndaj Ishujve Faroe. Në anën tjetër edhe Shqipëria që u paraqitë shkëlqyeshëm ndaj Italisë por pësoi humbje (1-3), synon që në ndeshjen ndaj Armenisë të shënon fitore dhe të mbyllë vitin me fitore. Përparësi e kuqezinjve që drejtohen nga trajneri Edy Reja është fakti se kjo ndeshje zhvillohet në "Air Albania" dhe pritet që të ketë shikues që do t'i mbështesin futbollistët shqiptarë. Lidhur me këtë ndeshje miqësore, trajneri Reja është deklaruar: "Bëhet një vit e 3 ditë nga fitorja e fundit që kemi pasur me Shqipërinë sigurisht që nuk më pëlqen, nuk dua të krijoj pritshmëri sa i përket rezultatit nesër, dua të provoj disa lojtarë të rinj që kanë ardhur nga Superioria dhe që kanë bërë mirë me Katarin dhe Arabinë Saudite dhe do doja t'i provoja". Ndeshja Kosovë-Ishujt Faroe fillon në orën 18:00 dhe zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri", derisa ndeshja tjetër mes Shqipërisë dhe Armenisë zhvillohet tridhjetë minuta me herët.



## Sonte Peja - Vëllaznimi, nesër derbi Prishtina - Trepça



PRISHTINË, 18 NËNTOR - Në fundjavë zhvillohet xhiroja e 11-të në Prince Caffe Superligën e Kosovës në basketboll. Derbi do të zhvillohet ndërmjet rivalëve të vjetër të basketbollit të Kosovës, Sigal Prishtinës dhe Trepçës. Prishtinasit kanë gjashtë fitore e katër humbje, kurse mitrovicasit kanë gjashtë fitore e tri humbje. Në takimin e parë të këtij edicioni "Xehetarët" fituan 80:75. Sfidat ndërmjet këtyre dy skuadrave gjithmonë kanë qenë interesante dhe kështu pritet edhe të dielën. Liderja e elitës, Peja, me tetë fitore e një humbje do të ndeshet me Vëllaznimin, që numëron katër fitore e gjashtë humbje. Pejanët synojnë të vazhdojnë të jenë në krye të elitës, kurse kuqezinjtë kanë treguar paraqitje të mira në këtë edicion dhe synojnë paraqitje të mira edhe në Pejë. Përballje shumë e rëndësishme dhe jetike do të zhvillohet ndërmjet Rahovecit dhe Bashkimit. Vreshtarët kanë një fitore e nëntë humbje, kurse prizrenasit kanë katër fitore e gjashtë humbje, andaj sfida pritet të jetë shumë interesante ndërmjet skuadrave që synojnë fitoren në këtë përballje. Golden Eagle Ylli - Ponte Prizreni do të regjistrohet rezultati nga Liga Unike.

**SUPERLIGA - Java 11**

*Të shtunën takohen:*
19:00 Peja - Vëllaznimi

*Të dielën takohen:*
17:00 Sigal Prishtina - Trepça
19:00 Rahoveci - Bashkimi
Golden Eagle Ylli - Ponte Prizreni (Rezultati i Ligës Unike)

## Vëmendja në Vushtrri



PRISHTINË, 18 NËNTOR - Në Vushtrri do të jetë vëmendja e tifozëve të hendbollit sa iu takon ndeshjeve të xhiros së nëntë të Superligës. Të shtunën prej orës 19:00 në palestrën "Jeton Tërstena - Tota" është derbi regjional në mes të Vushtrrisë dhe Trepçës. Të dyja skuadrat kanë pretendime për fitore, ndërsa ndeshja pritet të jetë e fortë dhe interesante deri në fund. Po ashtu, pritet numër i madh i shikuesve. Vushtrria është e shtata në tabelë me 4 pikë, përkatësisht me dy fitore e katër humbje. Trepça ka pesë fitore dhe dy humbje, ndërsa renditet e treta me 10 pikë. Të shtunën janë edhe ndeshjet Prishtina - Vëllaznimi (16:00) dhe Llapi - Kastrioti (19:00). Prishtina e Kastrioti janë favoritë, por Vëllaznimi vazhdimisht kërkon fitore ndaj skuadrave që i ka më lart në tabelë. Xhiroja e nëntë mbyllet të dielën kur Besa Famgas e pret Deçanin. Kampionia dhe liderja, Besa Famgas, është favorite në ndeshjen që zhvillohet prej orës 18:00 në Pejë.

## Duranti i jep fitoren Brooklynit, clippersat mposhtin rivalët e Detroitit




**Brooklyn, 18 nëntor** - Tri ndeshje të luajtura në NBA. Skuadra e Brooklyn Netsit fitoi me rezultat 109-107 ndaj Portlandit, një përballje e hapur deri në fund. Vendimtar për miqtë ishte Duranti, autor i 35 pikëve, që thuajse i vetëm mposhti Portlandin. Për vendasit, Lillardi me 25 pikë e Simonsi me 24 u përpoqën t'i japin fitoren ekipit të tyre, por pa sukses. Fitore të rëndësishme për një vend në "play-off" korri ekipi i clippersave, që mundi me rezultat 96-91 Detroitin. Bogdanoviqi me 26 pikë ishte më i miri për miqtë, por i vetëm nuk mundi ta bëjë diferencën në fushë. Për clippersat u dallua Jacksoni me 23 pikë, ndërkohë që u rikthye pas dëmtimit Leonardi (6 pikë). Fitore të thellë korri skuadra e Sacramentos, që mundi me rezultat 130-112 San Antonion. Ndeshje spektakolare, ku për vendasit shkëlqyen Fox me 28 pikë e Monk me 26, ndërsa për Spursat u dallua Vassell me 29 pikë, por që mbetën për statistikë.

# Hajrizi: Të lumtur që po fillon Liga e Veteranëve

**Prishtinë, 18 nëntor** - Të dielën fillon Liga e Veteranëve. Shumë ish-basketbollistë do të rikthehen në parket, ku kanë kaluar me dekada të tëra. Kryesuesi i Komisionit të Veteranëve, Naim Hajrizi, ka folur rreth idesë së themelimit të Ligës së Veteranëve. "Ideja ka lindur nga unë dhe Blerinë Vuniqi për të filluar një aktivitet për veteranë. Me njoftimin e disa ish-basketbollistëve nga klubet e Kosovës, të gjithë e kanë mirëpritur dhe e kanë përkrahur këtë ide", ka thënë Hajrizi për faqen zyrtare të FBK-së.



Xhiroja e parë do të zhvillohet në Therandë të dielën. "Këtë fundjavë do të fillojmë me xhiron e parë, ku do të marrin pjesë gjashtë skuadra: Trepça, Prishtina, Peja, Bashkimi, Ylli dhe Vëllaznimi. Besoj se shumë shpejt do të paraqiten edhe skuadra të tjera që kanë interesim dhe do të bëhemi më tepër skuadra", ka shtuar ish-basketbollisti mitrovicas. Kjo ide është përkrahur nga Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK). "Jam shumë i gëzuar që kjo iniciativë ka hasur në mirëkuptimin e Federatës dhe ata janë shumë të interesuar që kjo ligë të ketë suksese dhe të ketë vazhdimësi. U uroj të gjitha ekipeve pjesëmarrëse për suksese por, para së gjithash, shëndet dhe kënaqësi në lojërat të cilat na presin", ka përfunduar Hajrizi.

Federata e Basketbollit e Kosovës në kuadër të Planit Strategjik 2021-2025 e ka përfshirjen e të gjithë komunitetit të basketbollit në aktivitetet e saj, andaj formimi i Komisionit të Veteranëve është një nga objektivat për realizimin e këtij qëllimi.

# Ronaldo: Messi dhe Zidane janë lojtarët më të mirë që kam parë

